



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 15

2001

Prill

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8749 datë 1.3.2001	Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik	413
Ligj nr.8754 datë 26.3.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave”	415
Ligj nr.8755 datë 26.3.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit European për programet e ndihmës humanitare”	432
Ligj nr.8756 datë 26.3.2001	Për emergjencat civile	435
Ligj nr.8757 datë 26.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”	446
Ligj nr.8758 datë 26.3.2001	Për një ndryshim në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”	450

Ligj nr.8759 datë 26.3.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën ndërkombëtare për asistencë të ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore”	450
Ligj nr.8760 datë 26.3.2001	Për pagesat me këste të taksave nga operatorët privatë radio dhe televizivë gjatë periudhës tranzitore të vitit 2001	470
Vendim i Kuvendit nr.478, datë 9.3.2001	Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për verifikimin e listave dhe të ndarjes së zonave zgjedhore	470
Vendim i Kuvendit nr.479, datë 9.3.2001	Për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për verifikimin e listave dhe të ndarjes së zonave zgjedhore	473
Vendim i Kuvendit nr.482, datë 26.3.2001	Për mosmiratimin e mocionit për debat me objekt propozimin për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm	473
Kuvendi i Shqipërisë datë 9.3.2001	Deklaratë	474
Vendim i KM nr.127, datë 15.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.415, datë 1.7.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e komitetit “Gruaja dhe familja””	474
Vendim i KM nr.128, datë 15.3.2001	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 220/110 kv, në Sharrë, Tiranë	475

L I G J
Nr.8749, datë 1.3.2001

PËR SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM
NË MINISTRINË E RENDIT PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Në Ministrinë e Rendit Publik krijohet Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, në varësi të Ministrit të Rendit Publik.

Struktura e këtij Shërbimi është unike dhe drejtohet nga Drejtori i Shërbimit.

Neni 2

Objekti i punës së këtij Shërbimi është parandalimi, zbulimi dhe dokumentimi i veprimtarisë kriminale që kryhet nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera të Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 3

Punonjësit e këtij shërbimi gëzojnë atributet e policisë gjyqësore.

Në këtë strukturë funksionojnë shërbime të policisë gjyqësore sipas ligjit nr.8677, datë 2.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

Neni 4

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik është strukturë e veçantë e pavarur policore në zbatimin e ligjit.

Veprimtaria verifikuese dhe hetimi paraprak i këtij Shërbimi kryhet duke respektuar garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Neni 5

Për përmbushjen e detyrave, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm ka të drejtë të mbledhë, të administrojë, të ruajë dhe të verifikojë të dhënat për veprimtaritë kriminale, kur ato kryhen nga punonjësi i Policisë së Shtetit i Ministrisë së Rendit Publik, pavarësisht nga detyra dhe grada.

Neni 6

Gjatë ushtrimit të detyrave të tij ky Shërbim ka të drejtë të kryejë verifikime në të gjitha arkivat e Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit.

Rregulli për shfrytëzimin e tyre përcaktohet me akt normativ të Ministrit të Rendit Publik.

Autoritetet policore, për zbatimin e këtij ligji, janë të detyruara të bashkëveprojnë me këtë Shërbim.

Neni 7

Punonjësit e Policisë së Shtetit ose i Ministrisë së Rendit Publik kur, për shkak të detyrës, vihen në dijeni se po përgatitet, po kryhet ose është kryer një veprë penale nga subjekte të strukturave të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, detyrohen të njoftojnë Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm.

Strukturat e tjera policore bëjnë verifikime për veprat penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, duke vënë në dijeni për këtë Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm.

Autoriteti policor, kur realizon veprimet e kapjes në flagrancë të një punonjësi policie, është i detyruar të njoftojë menjëherë Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm.

Neni 8

Të dhënat e marra nga shërbime të tjera informative ose nga institucionet e ndryshme shtetërore për përfshirje dhe veprimtari kriminale të punonjësit të Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera të Ministrisë së Rendit Publik, i kalohen këtij Shërbimi.

Neni 9

Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik përzgjidhet nga efektivitë e policisë, duke marrë për bazë ndershmërinë, profesionalizmin dhe njohuritë e tij për legjislacionin, si dhe me përvojë jo më pak se tre vjet rradhazi në sektorin e verifikimeve dhe të hetimit paraprak. Ai nuk duhet të jetë dënuar penalisht dhe së paku për tre vjet në detyrë të mos ketë marrë masa të rënda ndëshkuese, disiplinore dhe administrative.

Emërimi, lirimi, largimi dhe përjashtimi nga detyra bëhet nga Ministri i Rendit Publik me propozimin e Drejtorit të këtij Shërbimit.

Neni 10

Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, pas periudhës së caktuar për të punuar në këtë shërbim, dërgohet në një vend tjetër pune ose në një sektor tjetër, në përputhje me aftësitë e veta profesionale dhe me kërkesat e ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

Neni 11

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm për realizimin e misionit që ka, bashkëpunon dhe shkëmben të dhëna me Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Shërbimin Informativ të Forcave të Armatosura dhe me shërbimet homologe të vendeve të tjera, në bazë të marrëveshjeve konkrete, me miratim të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 12

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm e ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këtë ligj dhe me Kodin e Procedurës Penale.

Ministri i Rendit Publik ose personi i autorizuar prej tij është përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së këtij Shërbimi. Për të siguruar zbatimin e ligjit, Prokurori i Përgjithshëm informohet nëpërmjet një prokurori të caktuar për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm për çështjet policore të një natyre kriminale.

Neni 13

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e dokumentacionit dhe të të dhënave.

Neni 14

Dokumentacionet e Shërbimit Informativ të Rendit (SHIR) i kalojnë në dispozicion Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

Neni 15

Ngarkohet Ministri i Rendit Publik të nxjerrë akte normative:

- a) për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm;
- b) për shfrytëzimin e arkivave të Ministrisë së Rendit Publik e të Policisë së Shtetit nga ky Shërbim.

Neni 16

Ligji nr.7530, datë 11.12.1991 “Për shërbimin e kundërzbulimit në organet e Rendit Publik”, ndryshuar me ligjin nr.7882, datë 1.12.1994, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2921, datë 15.3.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J **Nr.8754, datë 26.3.2001**

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR HARMONIZIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN KUFITAR TË MALLRAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **V E N D O S I :**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2955, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONVENTA
NDËRKOMBËTAREPËR HARMONIZIMIN E RREGULLAVE PËR KONTROLLIN KUFITAR
TË MALLRAVE

HYRJA

Palët kontraktuese,
Duke patur si dëshirë të përmirësojnë lëvizjen ndërkombëtare të mallrave,
Duke patur në mend nevojën për të lehtësuar kalimin e mallrave në kufi,
Duke venë re se masat e kontrollit që zbatohen në kufi kryhen nga shërbime të ndryshme të kontrollit,

Duke njohur faktin që kushtet në të cilat kryhen këto kontrolle mund të harmonizohen pa dëmtuar qëllimin në vetvete të kontrollit dhe të efektivitetit të tij,

Të bindur se harmonizimi i rregullave të kontrollit kufitar përbën një mjet të fuqishëm për arritjen e këtyre objektivave,

kanë rënë dakord si vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Konvente:

(a) "Dogana" do të thotë Shërbimi Qeveritar që është përgjegjës për administrimin dhe zbatimin e ligjit të doganave, lidhur me mbledhjen e taksave nga doganat, si dhe ka përgjegjësi për zbatimin e ligjeve dhe rregullave lidhur me të, ku ndër të tjera përfshihet transportimi, tranzitimi dhe eksportimi i mallrave;

(b) "Kontroll Doganor" do të thotë masat e zbatuara për të siguruar përputhjen me ligjet dhe rregullat të cilat autoritetet doganore duhet të zbatojnë gjatë aktivitetit të tyre;

(c) "Inspektim Mjeko – Sanitar" do të thotë kontrollet e ushtruara për mbrojtjen e jetës, të shëndetit, të personit, duke përjashtuar kontrollin veterinar;

(d) "Kontroll Veterinar" do të thotë kontrolli shëndetësor i ushtruar te kafshët dhe prodhimet e tyre, duke synuar në mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave dhe kafshëve. Ky kontroll do të ushtrohet edhe mbi mjetet dhe të mirat të cilat do të shërbejnë për transportimin e sëmundjeve të kafshëve;

(e) "Kontroll Fitosanitar" do të thotë kontrolli që ka si qëllim parandalimin e shpërndarjes dhe hyrjen në kufijtë shtetërore të sëmundjeve të bimëve ose të prodhimeve nga bimët;

(f) "Kontrolli për Standardet Teknike" do të thotë kontrolli i ushtruar për të siguruar që mallrat të gëzojnë standardet minimum kombëtar dhe ndërkombëtar, ashtu siç përcaktohet në ligjet dhe rregulloret e veçanta;

(g) "Kontroll i Cilësisë" do të thotë, përveç formave të kontrolleve të përmendura më sipër, kontroll i ushtruar më qëllim që mallrat të jenë brenda parametrave kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ashtu siç përcaktohet në ligjet e rregulloret e veçanta;

(h) "Kontrolli i Shërbimeve" do të thotë çdo shërbim i kryer për të kontrolluar gjithë kontrollet e kryera më parë, lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitimin e mallrave.

Neni 2
Qëllimi

Me qëllim lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave, kjo Konventë ka si qëllim të përmirësojë kuadrin ligjor për kryerjen e formaliteteve sidomos të numrit dhe kohëzgjatjes së kontrollit, në

veçanti të koordinimit të rregullave dhe procedurave kombëtare dhe ndërkombëtare për kryerjen e kontrollit.

Neni 3 **Shtrirja**

1. Kjo Konventë aplikohet mbi të gjithë mallrat e importuara, të eksportuara ose në tranzit, të cilat janë transportuar me një nga mjetet e transportit, qoftë ky detar, rrugor dhe ajror.

2. Kjo Konventë do të aplikohet për të gjithë shërbimet e kontrollit të kryera nga palët kontraktuese.

KREU II HARMONIZIMI I PROCEDURAVE

Neni 4 **Koordinimi i Kontrolleve**

Palët nënshkruese, brenda mundësive të tyre, do të ndërmarrin masa për harmonizimin e rregullave në kontrollin e shërbimeve doganore dhe të shërbimeve të tjera të Kontrollit.

Neni 5 **Mjetet e kërkuara për kryerjen e këtyre shërbimeve**

Në mënyrë që kontrolli të kryhet në mënyrë të suksesshme, palët kontraktuese, brenda mundësive të tyre, dhe duke respektuar kuadrin e tyre të brendshëm ligjor, të sigurojnë:

- (a) personelin e kualifikuar në përputhje me shkallën e kërkesave të trafikut;
- (b) pajisjet dhe lehtësitë për kryerjen e kontrollit, duke patur parasysh llojin e transportit, mallrat të cilat do të kontrollohen, si dhe kërkesat e qarkullimit;
- (c) udhëzime zyrtare në drejtim të personelit të kontrollit në mënyrë që aktiviteti i tyre të jetë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me rregullat e tjera të legjislacionit të brendshëm.

Neni 6 **Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

Palët kontraktuese marrin përsipër detyrimin të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, duke kërkuar të njëjtin bashkëpunim edhe nga autoritetet kompetente ndërkombëtare, me qëllim arritjen e qëllimeve të Konventës, duke u përpjekur kështu, në hartimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, në qoftë se kjo konsiderohet e nevojshme nisur nga rrethanat.

Neni 7 **Bashkëpunimi ndërmjet vendeve të anëtarësuara në këtë Konventë**

Në çdo rast, që një kufi i një shteti të caktuar kalohet, Palët kontraktuese të përfshira do të duhet të marrin masat e duhura, Që kur është e mundur, të lehtësojnë kalimin e mallrave.

Në këtë aspekt ato do të:

- (a) përpiqen të marrin masa për një kontroll të shpejtë të mallrave dhe dokumenteve shoqëruese, duke krijuar lehtësi në qarkullimin e tyre;
- (b) përpiqen që veprimet e tyre të jenë në pajtim:
 - me orët zyrtare të punës së postave kufitare;
 - me shërbimet e kontrollit që gjenden atje, të cilat janë të ngarkuara për kryerjen e kontrollit;
 - me kategoritë e mallrave, mënyrën e transportimit të tyre dhe në pajtim me procedurat e pranuar ose që janë në përdorim për tranzitimin ndërkombëtar të mallrave.

Neni 8

Shkëmbimi i Informacionit

Palët kontraktuese mund, me kërkesën e secilës, mund të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për zbatimin e detyrimeve të kësaj Konvente, ashtu siç është përcaktuar edhe te shtesat (anekset) e kësaj Konvente.

Neni 9

Dokumentacioni

1. Palët kontraktuese do të përpiqen të nxisin ndërmjet tyre dhe autoritetet ndërkombëtare kompetente për përdorimin e dokumentacionit, ashtu siç është parashikuar edhe në dokumentin e OKB-së.

2. Palët kontraktuese do të pranojnë dokumentet e miratuara sipas një procedure të caktuar, duke pasur parasysh që këto procedura të jenë në konformitet të plotë me ligjet e brendshme, duke respektuar ndër të tjera formën, autenticitetin dhe verifikimin, lexueshmërinë dhe kuptueshmërinë e tyre.

3. Palët kontraktuese do të marrin masa që dokumentacioni shoqërues dhe i domosdoshëm të përgatitet dhe vërtetohet në përputhje të plotë me legjislacionin e brendshëm të çdo vendi.

KREU III

RREGULLAT LIDHUR ME TRANZITIMIN E MALLRAVE

Neni 10

Mallrat në Tranzit

1. Palët kontraktuese, brenda mundësive të tyre, do të sigurojnë një trajtim të shpejtë dhe të thjeshtë të mallrave në tranzit, sidomos për mallrat të cilat transportohen nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e dispozitave të Tranzitimit Ndërkombëtar të Mallrave, duke parashikuar kufizimin e kontrolleve në rastet kur kjo diskutohet nga rrethanat e veçanta. Për këtë, do të merret në konsideratë edhe gjendja e vendeve të cilat nuk kanë dalje në det. Ato do të duhet të sigurojnë edhe zgjatjen e kohës së punës dhe dhënien e kompetencave më të mëdha për kontrollin kufitar të mallrave të cilat kryhen në bazë të dispozitave të Tranzitimit Ndërkombëtar të Mallrave.

2. Palët kontraktuese do të përpiqen të lehtësojnë në një masë sa më të madhe tranzitimin e mallrave me kamionë ose me mjete të tjera, duke u siguruar atyre shkallën e duhur të sigurisë.

KREU IV

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 11

Rendi Publik

1. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të pengojë zbatimin e kufizimeve ose ndalimeve, lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitimin e mallrave të cilat janë vendosur nga rendi publik, rregulla të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e jetës, shëndetit, sigurisë dhe moralit, mbrojtjen e mjedisit, pasurisë kulturore dhe industriale, pasurive dhe të drejtave intelektuale.

2. Megjithatë, kur është e mundur dhe pa ndonjë paragjykim për efektivitetin e këtyre kontrolleve, palët kontraktuese do të përpiqen të zbatojnë kontrollet, duke mbajtur parasysh edhe masat e përmendura në paragrafin e mësipërm, dhe ndër të tjera edhe masat të cilat janë përfshirë në nenet 6 dhe 9 të kësaj Konvente.

Neni 12
Masat Emergjente

1. Masat emergjente, të cilat një palë do të mund të aplikojë si pasojë e rasteve të veçanta, duhet të jenë në proporcion me arsyet dhe faktorët të cilët kanë çuar në ndodhjen e rasteve urgjente. Këto masa duhet të ekzistojnë sapo të hiqen ose mënjanoohen faktorët që çuan në marrjen e këtyre masave urgjente.

2. Kur është e mundur, dhe pa asnjë paragjykim për efektivitetin e masave të ndërmarra, palët kontraktuese duhet të botojnë dispozitat të cilat janë zbatuar për marrjen e masave urgjente.

Neni 13
Shtesat (Anekset)

1. Anekset janë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.

2. Aneksë të reja, lidhur me sektorë të tjerë të kontrollit, mund të përfshihen në këtë Konventë duke respektuar procedurat e përcaktuara në nenet 22 dhe 24 të kësaj Konvente.

Neni 14
Marrëdhëniet me Traktate të tjera

1. Pa asnjë paragjykim të nenit 6, Konventa në fjalë nuk do të ketë superioritet mbi të drejtat dhe detyrimet që shtetet, anëtare të kësaj Konvente kanë në bazë të Traktateve të tjera ku ato janë palë, para se të jenë bërë palë në këtë Konventë.

Neni 15

1. Kjo Konventë nuk do të përjashtojë zbatimin e lehtësirave më të mëdha të cilat 2 ose më shumë shtete palë të kësaj Konvente, duan t'i japin njëri-tjetrit. Po ashtu, kjo Konventë nuk do të përjashtojë as edhe të drejtën e shteteve anëtare të bëhen anëtare të organizatave të ndryshme të integritit ekonomik, siç është parashikuar në nenin 16, i cili bën fjalë për zbatimin e legjislacionit kombëtar në rastet e kontroleve në pikat kufitare, me kushtin e vetëm që ky kontroll të mos pengojë lëvizjen e mallrave.

Neni 16

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi. Aprovimi dhe aderimi

1. Konventa, e cila është depozituar tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, do të jetë e hapur për të gjitha shtetet dhe të gjitha organizatat e integritit ekonomik rajonal në të cilat kanë aderuar shtete të veçanta, të cilat kanë të drejtën dhe kompetencën të negociojnë, të arrijnë marrëveshje dhe të zbatojnë marrëveshjen e cila lidhet me çështje të cilat mbulojnë nga Konventa e mësipërme.

2. Organizatat e integritit ekonomik rajonal, siç është folur edhe në paragrafin e mësipërm për çështjet e përfshira brenda kompetencës së tyre, ushtrojnë në emër të tyre, të gjitha të drejtat dhe detyrimet, të cilat sipas kësaj Konvente do t'i përkisnin shteteve të veçantë, të cilët janë palë pjesëmarrëse të kësaj Konvente. Në raste të tilla, anëtarët e kësaj Organizate nuk kanë të drejtë të ushtrojnë individualisht të drejtat, përfshirë këtu edhe të drejtën e votës.

3. Shtetet, si dhe organizata e integritit ekonomik rajonal, e përmendur më sipër, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë Konventë:

(a) duke depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit ose aprovimit, pasi ajo është nënshkruar;

(b) ose duke depozituar instrumentin e aderimit.

4. Kjo Konventë do të qëndrojë e hapur që nga 1 Prill 1983 deri 31 Mars 1984, vetëm për nënshkrimin në Zyrat e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë nga të gjitha Shtetet dhe nga organizatat e integritit ekonomik rajonal të përmendura në paragrafin 1.

5. Nga 1 prilli 1983 ajo do të jetë e hapur për aderimin e tyre.

6. Instrumenti i ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit do të depozitohet në Sekretariatit e Përgjithshëm në Kombet e Bashkuara.

Neni 17 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën pesë Shtetet kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

2. Pasi të pesë Shtetet të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për Palë të tjera Kontraktuese tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit, ose aderimit.

3. Çdo instrument i ratifikimit, pranimit, aprovimit, ose aderimit i depozituar pas hyrjes në fuqi të amendamenteve të kësaj Konvente, do të gjykohet të aplikojë në këtë Konventë të ndryshuar.

4. Çdo instrument i depozituar, pasi amendamentet të jenë pranuar në përputhje me procedurat e nenit 22, por para se instrumenti të ketë hyrë në fuqi, do të gjykohet si i aplikuar në këtë Konventë të ndryshuar në datën që amendamenti hyn në fuqi.

Neni 18 **Denoncim**

1. Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë, duke i dërguar njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të ketë efekt 6 muaj nga data e marrjes së këtij materiali denoncimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 19 **Mbarimi**

1. Në qoftë se pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, numri i shteteve të cilat janë palë, është reduktuar në më pak se 5 shtete, për një periudhë 12 mujore, Konventa do të pushojë së pasuri efekt pas përfundimit të periudhës 12 mujore.

Neni 20 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të zgjidhet, me sa është e mundur, nëpërmjet negociimit ndërmjet tyre ose me anë të mjeteve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk mund të zgjidhet me mjetet që tregohen në paragrafin e parë të këtij neni, me kërkesën e njërit prej tyre, do t'i parashtrahet një gjykatë arbitrazhi, e përbërë si më poshtë: secila palë në mosmarrëveshje do të emërojë një arbitër dhe të dy arbitrat e caktuar nga palët, caktojnë një arbitër tjetër i cili do të jetë kryetari i arbitrazhit. Në qoftë se tre muaj pas marrjes së kërkesës, njëra nga palët ka dështuar në emërimin e arbitrit të saj, ose në qoftë se arbitrat kanë dështuar në zgjedhjen e kryetarit, secila nga palët mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të emërojë një arbitër ose kryetar të gjykatës së arbitrazhit.

3. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit, i marrë sipas paragrafit 2, do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për secilën palë në mosmarrëveshje.

4. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë rregullat e saj të procedimit.

5. Gjykata e arbitrazhit do të marrë vendimet e saj me anë të votimit të shumicës, në bazë të marrëveshjeve që ekzitojnë ndërmjet palëve në mosmarrëveshje dhe sipas ligjeve të përgjithshme ndërkombëtare.

6. Çdo kundërshtim, i cili mund të ngrihet ndërmjet palëve për mosmarrëveshjen në lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin e vendimit të gjyqit, mund të dërgohet, nga secila palë, për gjykim në gjykatën e arbitrazhit e cila ka marrë vendimin e gjykimit.

7. Secila palë në mosmarrëveshje do të marrë përsipër shpenzimet lidhur me arbitrin e emëruar dhe të përfaqësuesve të tij në një proces arbitrazhi, shpenzimet e Kryetarit dhe shpenzimet e tjera të cilat do të ndahen në pjesë të barabarta ndërmjet palëve në mosmarrëveshje.

Neni 21

Rezervimet

1. Çdo palë kontraktuese mundet, në kohën e nënshkrimit, të ratifikimit, pranimit ose aprovimit të kësaj Konvente ose të aderimit në të, të deklarojë se nuk e konsideron veten të lidhur me nenin 20/2 deri në paragrafin 7 të kësaj Konvente. Palët e tjera kontraktuese, nuk do të jenë të lidhur me këtë paragraf, në marrëdhënie me çdo shtet, palë të kësaj Konvente, e cila e ka bërë një rezervim të tillë.

2. Çdo palë kontraktuese, që ka bërë një rezervim sipas paragrafit të mësipërm, mund në çdo kohë të tërheqë këtë rezervim, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së.

3. Përveç rezervimit, që është parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk do të lejohet asnjë lloj rezervimi tjetër që mund të bëhet nga çdo palë e kësaj Konvente.

Neni 22

Procedura për ndryshime në këtë Konventë

1. Kjo Konventë, duke përfshirë dhe anekset e saj, mund të ndryshojë me propozimin e palëve kontraktuese, sipas procedurave të veçanta të këtij neni.

2. Çdo ndryshim, i propozuar në këtë Konventë, do të merret në shqyrtim nga një Komitet Administrativ i përbërë nga të gjithë palët kontraktuese, duke respektuar rregullat e procedurës të përfshira në aneksin 7. Çdo ndryshim që është shqyrtuar ose miratuar gjatë takimit të Komitetit Administrativ dhe është adaptuar nga ai, duhet të komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së palëve kontraktuese për aderim.

3. Çdo ndryshim, i propozuar dhe i komunikuar në pajtim me paragrafin e mësipërm, do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet palë të kësaj Konvente, 3 muaj pas përfundimit të periudhës 12 mujore, duke filluar afati që nga data e komunikimit të ndryshimit të propozuar, periudhë gjatë së cilës, asnjë kundërshtim për ndryshimin e bërë nuk është paraqitur tek Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së nga shteti i cili është palë e kësaj Konvente, ose nga një organizatë rajonale e integritimit ekonomik, e cila është palë e kësaj Konvente dhe vepron në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 16 të paragrafit 2 të kësaj Konvente.

4. Në qoftë se një kundërshtim për ndryshimin e propozuar është komunikuar lidhur me paragrafin 3 të këtij neni, ndryshimi do të merret si i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë lloj efekti.

Neni 23

Kërkesat, komunikimet dhe kundërshtimet

1. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftojë të gjitha palët kontraktuese dhe të gjitha shtetet për çdo kërkesë, komunikim ose kundërshtim sipas nenit 22, si dhe për datën në të cilën çdo amendament hyj në fuqi.

Neni 24
Konferenca Rishikuese

Pas një kohe 5-vjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo palë e kësaj Konvente, nëpërmjet njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, të kërkojë të mbledhë konferencën me qëllimin e rishikimit të Konventës, duke treguar edhe propozimet të cilat do të jenë objekt diskutimi nga Konferenca. Në këto raste:

1. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftojë të gjitha palët nënshkruese për kërkesën e bërë nga një shtet dhe t'i ftojë ato të parashtrajnë, brenda një kohe prej 3 muajsh, komentet e tyre, lidhur me propozimet ose me propozimet e tjera të cilat konferenca mund t'i marrë në konsideratë për t'i diskutuar.

2. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do t'i japë të gjitha palëve tekstin e propozimeve dhe do të mbledhë konferencën nëse, 6 muaj pas komunikimit në fjalë, jo më pak se 1/3 e palëve të kenë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së për miratimin e tyre për mbledhjen e kësaj Konference.

3. Megjithatë, në qoftë se Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e konsideron se një propozim për rishikimin e Konventës ka të bëjë më tepër me amendimin e tij, siç parashikohet edhe në nenin 22/1, ai mund, duke marrë edhe pëlqimin e palës që ka bërë propozimin, të zbatojë procedurat e ndryshimit të parashikuar në nenin 22, në vend të përdorimit të procedurës së rishikimit.

Neni 25
Njoftimet

Përveç rasteve të lajmërimeve dhe komunikimeve të parashikuara në nenet 23 dhe 24, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftojë të gjitha shtetet përsa vijon:

- (a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe aderimet në bazë të nenit 16;
- (b) datat e hyrjes në fuqi të Konventës, në zbatim të nenit 17 të kësaj Konvente;
- (c) denoncimet, në bazë të nenit 18;
- (d) mbarimin e kësaj Konvente, në bazë të nenit 19.

Neni 26
Kopjet origjinale

Pas 31 Marsit 1984, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të komunikojë dy kopje të vërtetuara të kësaj Konvente secilës palë të kësaj Konvente, si dhe të gjitha shteteve të tjera që nuk janë palë të kësaj Konvente.

Bërë në Gjenevë në datën 21 Tetor 1982, në një kopje origjinale. Kopjet në anglisht, frengjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëllor autentike.

Sa më sipër, palët e autorizuara e kanë nënshkruar këtë Konventë.

ANEKSI 1
HARMONIZIMI I KONTROLLIT DOGANOR DHE KONTROLLEVE TË TJERA

Neni 1
Parimet

1. Duke patur parasysh që shërbimi doganor ekziston në çdo vend, si dhe nisur nga natyra e tij e përgjithshme, të tjera kontrolle përveç atij doganor, për sa është e mundur, do të organizohen në një mënyrë të koordinuar me kontrollet doganore.

2. Në zbatim të këtij parimi, është e mundur që të sigurohet përdorimi i procedurave të cilat do të mund të lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, në qoftë se këto kontrolle ose pjesët e tyre do të ushtrohen jo në pikat e kalimit të kufirit.

Neni 2

1. Shërbimet doganore do të mbahen vazhdimisht të informuara për kërkesat ligjore ose rregulloret të cilat zbatohen në rastet e kontrolleve të tjera përveç kontrolleve doganore.

2. Kur gjykohet se të tjera kontrolle janë të nevojshme, doganat do të marrin masa që shërbimet e kryera për kontrollet e tjera, ndryshe nga kontrolli doganor, të bashkëpunojnë me këtë të fundit.

Neni 3

Organizimi i Kontrolleve

1. Kur kontrolle të ndryshme duhet të organizohen në të njëjtin vend, organet kompetente të shërbimit do të marrin masat e duhura për të kryer këto kontrolle në të njëjtën kohë, në qoftë se është e mundur dhe me sa më pak vonesë.

2. Në veçanti, organet kompetente do të marrin të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e personelit dhe të lehtësive të tjera në vendin ku do të kryhen kontrollet.

3. Doganat mund, nëpërmjet delegimit të shprehur të pushtetit nga organet kompetente të shërbimit, të kryejë në emër të tyre të gjitha ose pjesë të kontrolleve për të cilat organet kompetente janë përgjegjëse. Në këtë rast, këto shërbime, do të marrin masa për ofrimin e mjeteve të duhura doganave për të kryer kontrollin e deleguar.

Neni 4

Rezultatet e Kontrollit

1. Të gjitha çështjet për të cilat bën fjalë kjo Konventë, shërbimet e kontrollit dhe shërbimet doganore do të shkëmbejnë të gjitha informacionet lidhur me këto kontrolle sa më shpejt që të jetë e mundur, për të siguruar efikasitetin e kontrollit.

2. Në bazë të rezultateve të kontrolleve të kryera, autoritetet kompetente do të vendosin se çfarë trajtimi do t'i nënshtrohen mallrat e kontrolluara, dhe, në qoftë se është e nevojshme, do të informojnë shërbimet përgjegjëse për kryerjen e këtyre kontrolleve. Në bazë të këtij vendimi, shërbimi doganor do të zbatojë procedurat e veçanta doganore.

ANEKSI 2

KONTROLI MJEKO-VETERINAR

Neni 1

Parimet

Kurdo që të kryhet ky kontroll, ai do të respektojë parimet e parashtruara në këtë Konventë dhe sidomos ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2

Informacioni

Çdo palë kontraktuese do të sigurojë që informacioni, lidhur me mallrat e mëposhtme, të jetë në dispozicion të çdo subjekti të interesuar duke përfshirë:

mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit mjeko-sanitar;

vendet në të cilat mallrat do të mund të paraqiten për ushtrimin e kontrollit;

kërkesat e përcaktuara nga ligje dhe rregullore për kontrollet mjeko-sanitare, si dhe procedurat për aplikimin e tyre.

Neni 3

Organizimi i Kontrolleve

1. Shërbimet e kontrollit do të marrin masa për sigurimin e lehtësive, në pikat ku do të kryhet kontrolli mjeko-sanitar.

2. Kontrolli mjeko-ligjor mund të kryhet edhe në brendësi të territorit të një vendi, në qoftë se, nga certifikata e mallrave të transportuara dhe mjetet e transportit të cilat janë përdorur për transportimin e tyre, vërtetohet se mallrat nuk do të pësojnë ndonjë dëm ose do të shkaktojnë infektim gjatë transportimit të tyre.

3. Brenda kuadrit të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen sa është e mundur, të ulin numrin e kontrolleve të mallrave të cilat janë në tranzitim.

4. Kur mallrat duhet të ruhen derisa të përfundojnë procedurat e kontrollit mjeko-sanitar, shërbimet e organeve kompetente të çdo vendi, do të marrin masa për depozitimin e mallrave. Ky depozitim do të duhet të sigurojë kushtet e nevojshme për ruajtjen e mallrave, duke respektuar një minimum të kushteve të depozitimit të tyre.

Neni 4

Mallrat në Tranzit

Brenda kuadrit të kësaj Konvente, për sa është e mundur, palët kontraktuese do të merren me kontrollin mjeko-sanitar të mallrave në tranzit, duke respektuar kushtet që tranzitimi i tyre të mos sjellë rrezik për sëmundje infektive.

Neni 5

Bashkëpunimi

1. Shërbimet e inspektimit mjeko-sanitar do të bashkëpunojnë me shërbimet e njëjta të palëve kontraktuese, duke patur si qëllim lejimin e kalimit të mallrave të prishura, të cilat do t'i nënshtrohen kontrollit mjeko-sanitar, duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm.

2. Kur ngarkesa e mallrave të prishura është zbuluar gjatë kontrollit mjeko-sanitar, shërbimet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet e njëjta të vendeve të tjera, për destinacionin e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër që të jetë e mundur, duke përcaktuar arsyet të cilat çuan në kryerjen e kontrollit dhe masat pasuese të marra lidhur me mallrat e kontrolluara.

ANEKSI 3

KONTROLI VETERINAR

Neni 1

Parimet

Kurdo që të kryhet kontrolli veterinar, do të respektojë parimet e parashtruara në këtë Konventë dhe, sidomos, ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2

Përkufizimet

Kontrolli veterinar, i përcaktuar në nenin 1 (d) të kësaj Konvente, mbulon gjithashtu edhe kontrollin mbi mjetet dhe kushtet e transportit të kafshëve dhe të prodhimeve të kafshëve. Ky kontroll mund të përfshijë edhe kontrollet lidhur me cilësinë, standardet dhe rregullat e ndryshme, si p.sh. kontrolli që synon ruajtjen e llojeve të rrezikuara, të cilat, për arsye të rritjes së efektivitetit, shoqërohen me kontrolle veteriniare.

Neni 3 **Informacioni**

Çdo palë kontraktuese do të marrë masa që informacioni t'i sigurohet çdo personi të interesuar lidhur me çështjet e mëposhtme:

- Mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit veterinar;
- Vendet ku këto mallra i nënshtrohen kontrollit;
- Njoftimet e detyrueshme lidhur me sëmundjet e mundshme;
- Kërkesat ligjore lidhur me kontrollin veterinar, si dhe procedurat respektive lidhur me zbatimin e tij.

Neni 4 **Organizimi i Kontrolleve**

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:
 - të ngrejné, kur është e nevojshme dhe e mundshme, strukturat ndihmëse për kontrollin veterinar, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e qarkullimit të këtyre mallrave;
 - të krijojë lehtësi për lëvizjen e mallrave, sidomos duke koordinuar orët e punës së shërbimit të kontrollit veterinar me shërbimin e kontrollit doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës, kur ardhja e mallrave është lajmëruar më parë.
2. Kontrolli veterinar i prodhimeve të kafshëve duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet; si dhe mjetet e përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqësim ose përhapjen e sëmundjeve ngjitëse gjatë transportimit të tyre.
3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të mallrave të prishura në tranzitim.
4. Kur mallrat do të duhet të mbahen derisa të përfundojë kontrolli veterinar, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara duke pasur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet me sa më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5 **Mallrat në Tranzit**

Në kuadër të kësaj Konvente, çdo palë kontraktuese, sa të jetë e mundur, të reduktojë kontrollin veterinar të prodhimeve të kafshëve në tranzitim, kur, nisur nga rrethanat, nuk ka ndonjë rrezik për infektim me sëmundje ngjitëse.

Neni 6 **Bashkëpunimi**

1. Shërbimet e kontrollit veterinar do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i mallrave të cilat i nënshtrohen një kontrolli të tillë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.
2. Kur një ngarkesë e mallrave të prishura ose ngarkesë në kafshë të gjalla është zbuluar gjatë kontrollit veterinar e tyre, atëherë autoritetet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar malli, brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 4
KONTROLLI FITOSANITAR

Neni 1
Parimet

Kurdo që të kryhet kontrolli veterinar, do të respektojë parimet e parashtruara në këtë Konventë dhe sidomos ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2
Përkufizimet

Kontrolli fitosanitar i përcaktuar në nenin 1 (e) të kësaj Konvente mbulon edhe kontrollin e mjeteve dhe të kushteve të transportimit të bimëve dhe të prodhimeve të tyre. Ky kontroll mund të përfshijë edhe masat të cilat synojnë në ruajtjen e llojeve të bimëve të cilat janë të rrezikuara.

Neni 3
Informacioni

Çdo palë kontraktuese do të marrë masa që informacioni t'i sigurohet çdo personi të interesuar, lidhur me çështjet e mëposhtme:

Mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit fitosanitar;

Vendet ku bimët ose prodhimet e tyre do t'i nënshtrohen kontrollit;

Listën e sëmundjeve të bimëve ose prodhimeve të tyre, për të cilat ka një sërë ndalimesh ose kufizimesh;

Listën e kërkesave ligjore, lidhur me kontrollin fitosanitar, si dhe procedurat respektive lidhur me zbatimin e tij;

Neni 4
Organizimi i Kontrolleve

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:

të ngrejnjë, kur shihet e nevojshme dhe e mundshme, mjetet e nevojshme, si kontrollin e duhur fitosanitar, depozitimin dhe dizinfektimin e bimëve dhe prodhimeve të tyre, duke respektuar edhe kërkesat e qarkullimit të tyre;

të lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, sidomos koordinimin e orëve të punës së shërbimeve të kontrollit fitosanitar në atë të kontrollit doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës kur ardhja e mallrave është lajmëruar më parë.

2. Kontrolli fitosanitar i bimëve dhe prodhimeve të tyre duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet, si dhe mjetet e transportit të përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqësim ose përhapjen e sëmundjeve ngjitëse gjatë transportimit të tyre.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të bimëve ose prodhimeve të tyre të prishura të cilat janë në tranzitim.

4. Kur mallrat do të duhet të mbahen derisa të përfundojë kontrolli fitosanitar, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara, duke patur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet sa më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5
Mallrat në Tranzit

Në kuadër të kësaj Konvente, çdo palë kontraktuese, sa të jetë e mundur, do të reduktojë kontrollin fitosanitar të bimëve dhe të prodhimeve të tyre, kur, nisur nga rrethanat, këto mos shihen të rëndësishëm për mbrojtjen e bimëve.

Neni 6
Bashkëpunimi

1. Shërbimet e kontrollit fitosanitar do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i bimëve ose prodhimeve të tyre, të cilat i nënshtrohen një kontrolli të tillë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur një ngarkesë e bimëve ose prodhimeve të tyre të prishura, është zbuluar gjatë kontrollit fitosanitar të tyre, atëherë autoritetet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar bima brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 5
KONTROLLI I PËRPUTHSHMËRISË ME STANDARDET TEKNIKE

Neni 1
Parimet

Kurdo që zbatohet ky lloj kontrolli, ai duhet të jetë në përputhje me standardet teknike, lidhur me mallrat e përfshira në këtë Konventë, do të duhet të përputhet me parimet e parashtruara në Konventë dhe sidomos në Aneksin 1.

Neni 2
Informacioni

Secila palë do të sigurojë që informacioni të jetë në dispozicion të çdo personi të interesuar lidhur me:

Standardet e aplikuara në të;

Vendin në të cilin do të bëhet kontrolli i mallrave;

Kërkesat ligjore, lidhur me përputhshmërinë e kontrolleve me standardet teknike, si dhe procedurat e zbatuara për kryerjen e këtyre kontrolleve.

Neni 3
Harmonizimi i Standardeve

Në mungesë të standardeve ndërkombëtare, palët kontraktuese të cilat gjatë këtyre kontrolleve zbatojnë standarde kombëtare, do të marrin masat që këto standarde kombëtare të jenë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 4
Organizimi i Kontrolleve

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:
të ngrejnë, kur shihet e nevojshme dhe e mundshme, qendrat për përputhjen e kontrollit të kryer me standardet teknike, duke respektuar edhe kërkesat e qarkullimit të tyre;

të lehtësojë lëvizjen e lirë të mallrave, sidomos koordinimin e orëve të punës së shërbimeve të kontrollit për përputhshmërinë e kontrolleve, me standardet teknike me atë doganor, si dhe duke

siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës, kur ardhja e mallrave është lajmëruar më parë.

2. Kontrolli i përputhshmërisë me standardet teknike duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet, si dhe mjetet e transportit të përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqësim gjatë transportimit të tyre.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të mallrave të prishura që janë në tranzitim, të cilat i nënshtrohen kontrollit për përputhshmërinë me standardet teknike.

4. Palët kontraktuese do të organizojnë kontrolle të përputhshmërisë me standardet teknike, duke harmonizuar, kur është e mundur, procedurat e zbatuara për kontrollin e mallrave, të kryer nga shërbimet përgjegjëse, duke harmonizuar procedurat edhe me shërbimet e tjera përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve të tjera.

5. Në rastet e mallrave të prishura të cilat do të duhet të mbahen derisa të përfundojë kontrolli i përputhshmërisë me standardet teknike, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara, duke patur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet me sa më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5 **Mallrat në Tranzit**

Kontrollet për përputhshmërinë e mallrave me standardet teknike nuk do të zbatohen mbi mallrat të cilat do të kalojnë tranzit.

Neni 6 **Bashkëpunimi**

1. Shërbimet përgjegjëse për kontrollin e përputhshmërisë së mallrave me standardet teknike do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i mallrave të prishura, të cilat i nënshtrohen një kontrolli të tillë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur një ngarkesë e mallrave të prishura, është zbuluar gjatë kontrollit të ushtruar për përputhshmërinë e tyre me standardet teknike, atëhere autoritetet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar malli brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 6 **KONTROLLI I CILËSISË**

Neni 1 **Parimet**

Kurdo që zbatohet kontrolli i cilësisë së mallrave që përfshihen në këtë Konventë, do të duhet të përputhet me parimet e parashtruara në Konventë dhe sidomos në Aneksin 1.

Neni 2 **Informacioni**

Secila palë do të sigurojë që informacioni të jetë në dispozicion të çdo personi të interesuar lidhur me:

Vendin në të cilin do të bëhet kontrolli i mallrave;

Kërkesat ligjore lidhur me përputhshmërinë e kontrolleve të cilësisë, si dhe procedurat e zbatuara për kryerjen e këtyre kontrolleve.

Neni 3 **Organizimi i Kontrolleve**

1. Palët kontraktuese do të përpiqen:
të ngrejë, kur shihet e nevojshme dhe mundshme, qendrat e kontrollit të cilësisë, në përputhje me kërkesat e qarkullimit të mallrave;
të lehtësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, sidomos koordinimin e orëve të punës së shërbimeve të kontrollit të cilësisë me atë doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës për mallrat e prishura, kur ardhja e tyre është lajmëruar më parë.
2. Kontrolli i cilësisë duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që procedurat e përdorura gjatë kontrollit të lehtësojnë lëvizjen ndërkombëtare të mallrave.
3. Në kuadër të kësaj Konvente, palët kontraktuese do të përpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të mallrave të prishura që janë në tranzitim, të cilat i nënshtrohen kontrollit cilësor.
4. Palët kontraktuese do të organizojnë kontrolle cilësore, duke harmonizuar, kur është e mundur, procedurat e zbatuara për kontrollin e mallrave të kryer nga shërbimet përgjegjëse, duke harmonizuar procedurat edhe me shërbimet e tjera përgjegjëse për kryerjen e kontrolleve të tjera.

Neni 4 **Mallrat në Tranzit**

Kontrollet për cilësinë nuk do të zbatohen mbi mallrat të cilat do të kalojnë tranzit.

Neni 5 **Bashkëpunimi**

1. Shërbimet përgjegjëse për kontrollin e cilësisë do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i mallrave të prishura, të cilat i nënshtrohen kontrollit të cilësisë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.
2. Kur një ngarkesë e mallrave të prishura, është zbuluar gjatë kontrollit cilësor të ushtruar, atëhere autoritetet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar malli brenda një kohe sa më të shkurtër, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këtë rast.

ANEKSI 7 **RREGULLAT E PROCEDURËS PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT ADMINISTRATIV I CILI ËSHTË PËRMENDUR NË NENIN 22 TË KËSAJ KONVENTE**

Neni 1 **Anëtarët**

Anëtarë të Komitetit Administrativ do të jenë palët kontraktuese në këtë Konventë.

Neni 2 **Vëzhguesit**

1. Komiteti administrativ mund të vendosë të ftojë administratorët kompetentë nga të gjithë shtetet të cilat nuk janë palë të kësaj Konvente, ose përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat nuk janë palë kontraktuese për të ndjekur, pyetur për çështje që interesojnë atyre në sesionet e Komitetit me statusin e vëzhguesit.
2. Pa paragjykuar nenin 1 të kësaj Konvente, organizatat ndërkombëtare të cilave u referohemi në paragrafin 1, të cilat janë kompetente për çështjet e adresuara atyre në kuadër të anekseve të kësaj Konvente, kanë të drejtën të marrin pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit administrativ.

Neni 3
Sekretariati

Sekretari i Komitetit do të caktohet nga Sekretari ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën.

Neni 4
Mbledhjet e Komitetit

Sekretari ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën do të mbledhë Komitetin:

- (i) Dy vjet pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi;
- (ii) Pastaj në datën e caktuar nga Komiteti por jo më vonë se në periudhë 5-vjeçare;
- (iii) Me kërkesën e administratorëve kompetente së paku 5 shteteve të cilat janë palë të kësaj Konvente.

Neni 5
Zyrtarët

Komiteti do të zgjedhë një Kryetar dhe një nën-Kryetar me rastin e mbledhjes së çdo sezoni të tij.

Neni 6
Kuorumi

Një kuorum i përbërë nga jo më pak se 1/3 e shteteve të cilat janë palë të kësaj Konvente, kërkohet për efektin e marrjes së vendimit.

Neni 7
Vendimet

- (i) Propozimet do të hidhen në votë;
- (ii) Çdo shtet palë e kësaj Konvente, do të ketë të drejtën e një vote;
- (iii) Në rastin e zbatimit të nenit 16/2 të Konventës, palët e organizatave të integritit ekonomik rajonal do të kenë vetëm një të drejtë vote e cila do të jetë shuma e votave të shteteve të cilat janë palë të kësaj organizate. Në këto raste shtetet palë të kësaj Konvente nuk kanë të drejtën e votës.

(iv) Në rastet e parashikuara në nënparagrafin e mëposhtëm, çdo propozim do të miratohet nga një magjiorancë e thjeshtë që përfshin anëtarët e pranishëm të cilët do të votojnë në pajtim me kushtet e përcaktuara në paragrafin (ii) dhe (iii).

(v) Ndryshimet e kësaj Konvente do të miratohen nga 2/3 e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nënparagrafin (ii) dhe (iii).

Neni 8
Raporti

Para mbylljes së çdo sezoni, Komiteti do të miratojë raportin e tij.

Neni 9
Nene Shtese

Në mungesë të neneve të cilat nuk janë përfshirë në këtë Aneks, Rregullat e Procedurës të Komisionit Ekonomik për Europën do të jenë drejtpërdrejt të zbatueshme, përveç rasteve kur Komiteti vendos të veprojë ndryshe.

L I G J
Nr.8755, datë 26.3.2001

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETIT EUROPIAN PËR PROGRAMET E NDIHMËS HUMANITARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian për programet e ndihmës humanitare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2959, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE

MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETIT EUROPIAN MBI PROGRAMET E NDIHMËS HUMANITARE

Komisioni i Bashkimit Europian, që më poshtë do të quhet si “Komisioni”, duke vepruar nga një anë, dhe

Qeveria e Shqipërisë, duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë, të quajtur më poshtë si Shqipëria

Nga ana tjetër,

Dhe së bashku, të quajtura “Palët kontraktuese”

Duke marrë parasysh që Shqipëria po përfiton nga programi i ndihmës humanitare të Komunitetit si përshkruhet në Rregulloren e Këshillit Europian EC Nr.1257/96 të 20 Qershorit 1996,

Ka rënë në Marrëveshje si më poshtë:

Neni 1

Me qëllim që të realizojë bashkëpunimin midis palëve kontraktuese, me qëllim që të zbatojë veprime të ndihmës humanitare siç është cilësuar në Rregulloren e Këshillit të Komunitetit Europian nr.1257/96 të 20 Qershorit 1996, dhe e cila do financohet dhe zbatohet brenda kuadrit teknik, ligjor dhe administrativ të përcaktuar në kontratën e Partneritetit midis Komisionit Europian përmes ECHO-s (Zyra Humanitare e Komunitetit Europian) dhe partnerëve zbatues, Palët Kontraktuese bien dakord për artikujt e mëposhtëm të parashtuar në këtë Marrëveshje.

Detajet specifike të çdo veprimtarie janë vendosur në një kontratë veprimtarie midis partnerëve zbatues dhe Komisionit.

Shqipëria merr të gjithë hapat e nevojshëm që të sigurojë një zbatim të përpiktë të të gjitha veprimtarive.

Neni 2

Çdo veprimtari që është financuar brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet në përputhje me kushtet e vendosura në Ankesin 1.

Neni 3

Për çështje që lidhen me veprimtari të financuara brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të përfaqësohet në Shqipëri nga Delegacioni i tij në Tiranë, i cili do të sigurojë, në emër të Komisionit, që veprimtaritë janë ekzekutuar në përputhje me praktika të shëndosha financiare dhe teknike.

Neni 4

Kjo Marrëveshje është bërë në gjuhën angleze në dy kopje origjinale.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën që Palët Kontraktuese informojnë njëri-tjetrin për miratimin e saj në përputhje me procedurat e tyre të brendshme.

Marrëveshja do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej 5 vjetësh, në qoftë se nuk përfundohet sipas një deklarate me shkrim nga njëra ose tjetra palë kontraktuese. Marrëveshja do të përfundojë së zbatuari tre muaj pas kësaj deklarate.

Me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje çdo veprimtari që është akoma në zbatim do të përfundohet në përputhje me termat e Marrëveshjes aktuale.

Anekset do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë më 13.12.2000

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë Për Komisionin European
Ermelinda Mexsi Mishel Peretti

ANEKSI 1 FONDI I LEHTËSIVE

Neni 1

Përfitimet e përgjithshme

Personeli që bën pjesë në veprimtaritë humanitare të financuara nga Komuniteti dhe anëtarët e familjeve të tyre mund të marrin po ato përfitime, privilegje dhe përjashtime të bëra për të huajt e tjerë të punësuar nën ndonjë Marrëveshje bilaterale ose multilaterale për ndihmë ekonomike dhe program bashkëpunimi teknik.

Neni 2

Vendosja, akomodimi, hyrja dhe lehtësitë e qëndrimit

Shqipëria do të lejojë personelin që zbaton veprimtaritë e financuara nga Komuniteti dhe pjesëtarët e familjeve të tyre do të hyjnë në Shtetin Shqiptar, të vendosin veten e tyre në Shtet, të punojnë aty dhe të lënë Shtetin, ashtu siç e justifikon natyra e veprimtarisë së tyre.

Neni 3

Importi dhe rieksperti i pajisjeve

Shqipëria do të japë lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të nevojshme për të realizuar veprimtarinë, në bazë të ligjeve ekzistuese dhe rregulloreve të Shqipërisë.

Shqipëria do t'u japë personave fizikë dhe juridikë që e kanë kryer veprimtarinë, mundësinë të riekspertojë pajisjet e përmendura.

Neni 4

Taksat dhe Doganat

1. Importimet nga partnerët zbatues të mallrave të nevojshme në kuadrin e veprimtarive të financuara nën fondin e KE-së përmes ECHO-s do të përjashtohen nga çdo detyrim importi dhe taksa me efekt të njëjtë.

2. Shqipëria do të sigurojë që importimet do të bëhen nga pika e hyrjes për shpërndarje te partneri zbatues dhe për përdorim të menjëhershëm siç është kërkuar për zbatimin normal të veprimtarisë, pa asnjë vonesë ose keqkuptim, përsa i përket vendosjes së detyrimeve, taksave dhe tatimeve të sipërpërmendura.

Aty ku një kontratë furnizimesh e financuar nga fondet e KE-së përfshin një produkt që vjen nga Shqipëria, kontrata do të përfundohet në bazë të çmimeve të ish-punimeve të pajisjeve në fjalë, të cilave do t'iu shtohen tatimet e brendshme fiskale të zbatuara në Shqipëri për këto pajisje.

3. Sendet personale dhe shtëpiake të importuara për përdorim personal nga personat fizikë (dhe pjesëtarë të familjeve të tyre), përveç atyre të marra lokalisht, të ngarkuar që të realizojnë veprimtarinë do të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit ose tatime të tjera fiskale me të njëjtin efekt, sendet personale dhe shtëpiake të përmendura do të riekspertoohen ose nxirren jashtë përdorimit në përputhje me rregulloren në fuqi në Shqipëri pas përfundimit të veprimtarisë.

4. Personat fizikë dhe juridikë që importojnë pajisje profesionale, siç është parashikuar në Artikullin 3, do të përfitojnë, në qoftë se kërkohet, nga sistemi i pranimit të përkohshëm, siç është përcaktuar nga legjislacioni kombëtar i Shqipërisë për pajisjet e përmendura.

L I G J

Nr.8756, datë 26.3.2001

PËR EMERGJENCAT CIVILE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 170 dhe 174 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Planizimi dhe përballimi i emergjencave civile janë detyra të shtetit shqiptar që synon:

a) parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e

gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile;

b) sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile;

c) garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Neni 2 Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Emergjencë civile” kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

2. “Emergjencë civile kombëtare” kuptohet një situatë kritike urgjente e një natyre të përkohshme, që dëmton seriozisht jetën, shëndetin dhe sigurinë e shtetasve të Republikës së Shqipërisë, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë e natyrë të tillë që kalon mundësinë ose autoritetin e organeve të qeverisjes vendore për ta përballuar atë, ose kërcënon seriozisht mundësinë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të ruajtur sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të vendit.

3. “Fatkeqësi natyrore” kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësitrat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.

4. “Fatkeqësi të tjera” kuptohen aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimi njerëzor, nga luftërat ose gjendjet e emergjencës, si dhe format e tjera të dhunës masive.

5. “Fatkeqësi” kuptohet një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera të parashikuara në këtë ligj, të cilat kërcënojnë ose dëmtojnë jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë të tillë, që kërkojnë marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve të veçanta njerëzore e materiale-teknike.

6. “Masa mbrojtëse” kuptohen masat organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, kundër pasojave të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

7. “Operacion ndërhyrjeje” kuptohen veprimet e forcave dhe të mjeteve, për shpëtimin e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale (pronës) në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.

8. “Parandalim” kuptohet një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shmagjen ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja.

9. “Parashikim” kuptohen veprimtaritë që kryen për studimin dhe përcaktimin e shkaqeve të emergjencave, për përcaktimin e zonave, të territoreve dhe objekteve nga rreziqet e njëjta.

10. “Planizim e përballim të emergjencave civile” kuptohet përgatitja e autoriteteve publike, e institucioneve dhe organeve të qeverisjes qendrore e vendore, e personave juridikë, publikë ose privatë, e organizatave publike dhe e popullatës për një emergjencë civile, si dhe për rastet e një fatkeqësie natyrore, duke përcaktuar marrjen e masave për parandalimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga veprimi i rrethanave emergjente.

11. “Riaftësim” kuptohen masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme në rajonin (territorin) e prekur nga fatkeqësia.

12. “Rrezik” kuptohet një gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

13. “Shërbim të emergjencave civile” kuptohet shërbimi i bashkërenduar i Policisë së Shtetit dhe të gjitha policive të tjera, shërbimi i shpëtimit dhe i mbrojtjes nga zjarri dhe i urgjencës mjekësore.

14. “Vlerësim rreziku” kuptohet analiza sasiore e cilësore e natyrës dhe e rrethanave të tjera për ndodhinë e pritshme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Organet shtetërore, të përcaktuara në këtë ligj, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësia.

2. Organet shtetërore kanë të drejtë të përdorin çdo mjet publik ose privat, si dhe të bashkëpunojnë me organizata vullnetare që kanë rol të përcaktuar në situatat emergjente, për të shmangur ose për të reduktuar pasojat që shkaktohen nga fatkeqësitë, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për aq kohë sa vepron rrethana që i ka shkaktuar ato pasoja.

3. Strukturat e ngritura për planizimin dhe për përballimin e emergjencave civile funksionojnë si të tilla edhe në rastet kur me ligj shpallet gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e luftës ose gjendja e fatkeqësisë natyrore, duke pasur si qëllim kryesor marrjen e masave për parandalimin dhe riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e luftës ose gjendja e fatkeqësisë natyrore.

4. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me mundësitë e tij reale, ka për detyrë të ndihmojë në parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave që shkaktohen nga fatkeqësitë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

5. Asnjë organ, i përcaktuar në këtë ligj, nuk mund të ushtrojë përgjegjësi që nuk janë në sferën e veprimtarisë së tij.

6. Organet që, sipas këtij ligji, ngrihen për situata emergjente, janë fuqiplote, brenda përgjegjësisë dhe hierarkisë së tyre dhe veprojnë edhe pas kapërcimit të situatave emergjente, siç përcaktohet në pikat 1 dhe 2 të nenit 174 të Kushtetutës.

7. Organet, që sipas këtij ligji kanë natyrë operative, funksionojnë në mënyrë të përhershme dhe kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë ligj për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes dhe për riaftësimin e pasojave nga fatkeqësitë.

8. Aktet e organeve më të larta janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga organet më të ulta dhe nga çdo person fizik ose juridik. Ato marrin fuqi juridike në çastin e nxjerrjes së tyre. Organet që i nxjerrin këto akte detyrohen t’i vënë ato menjëherë në dispozicion të zbatuesve.

Neni 4

Llojet e strukturave

Për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile krijohen struktura mbi baza të përkohshme dhe të përhershme në nivel qendror dhe vendor.

KREU II
STRUKTURAT E PLANIZIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË
NIVEL QENDROR

Neni 5
Këshilli i Ministrave

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë.
2. Në ushtrimin e funksioneve të tij për këtë qëllim, Këshilli i Ministrave kryen këto detyra:
 - a) Miraton politikën dhe programet për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.
 - b) Miraton programin kombëtar dhe krijon kushte për arsimimin, trajnimin, planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.
 - c) Vendos për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes ose riaftësimin e pasojave të situatave të emergjencës civile.
 - ç) Informon Presidentin dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për emergjencën civile, për pasojat që vijnë, si dhe për masat e marra për shmangien e saj.
 - d) Kërkon pëlqimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.
 - dh) Vlerëson nivelin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, në bashkëpunim me specialistët e organeve përgjegjëse, si dhe asistencën për riaftësim.
 - e) Përcakton, në bashkëpunim me donatorët e huaj, procedurat për asistencën ndërkombëtare në rastet e emergjencave civile, në përputhje me konventën përkatëse ndërkombëtare të nënshkruar nga Qeveria Shqiptare.
 - ë) Planifikon fonde për mjete e pajisje rezervë të shtetit për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Neni 6
Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile

1. Për çdo rast të një emergjence civile kombëtare, sipas qëllimit dhe objektit të këtij ligji, pranë Këshillit të Ministrave krijohet Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile.
2. Këshilli i Ministrave përcakton kryetarin e këtij Komiteti dhe përbërjen e tij.
3. Komiteti Ndërmintor qëndron i mbledhur deri në shuarjen e shkaqeve që kanë çuar në emergjencë.
4. Komiteti Ndërmintor mund të thërrasë specialistë për këshillime në emergjenca.

Neni 7
Detyrat e Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile

- Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile kryen këto detyra:
- a) Bashkërendon veprimet e forcave të shërbimit të emergjencave civile.
 - b) Bashkërendon menaxhimin e rezervave shtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre.
 - c) Përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare në rast emergjence.
 - ç) Diskuton dhe vendos paraprakisht për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
 - d) Vlerëson rindërtimin dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, si dhe për të parandaluar dëmet e mundshme në të ardhmen dhe në sigurimin e kushteve bazë të jetesës.

dh) Në rastet e një emergjence civile kombëtare cakton drejtuesin e operacionit për menaxhimin e saj.

e) Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe detyra të veçanta, të caktuara nga Këshilli i Ministrave për përballimin e emergjencës civile.

Neni 8

Ministria e Pushtetit Vendor

1. Ministria e Pushtetit Vendor është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.

2. Ministria e Pushtetit Vendor kryen këto detyra:

a) Zbaton së bashku me institucionet e tjera politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.

b) Bashkërendon veprimet e të gjitha palëve në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile për përmbushjen e detyrave që u përkasin atyre dhe bashkërendon punët me organet e qeverisjes vendore për përballimin e emergjencave civile.

c) Organizon marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillimin dhe zbatimin e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.

ç) Menaxhon sistemin e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

d) Zhvillon strategjitë e programeve të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe i paraqet ato për miratim në Këshillin e Ministrave.

dh) Përpunon zbatimin e programeve të arsimit dhe të trajnimit në fushën e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

e) Në bashkëpunim me ministritë, institucionet dhe entet e ndryshme të vendit bën vlerësimin e rreziqeve mbi të cilat bazohet plani kombëtar i emergjencave civile dhe e paraqet atë për miratim në Këshillin e Ministrave.

ë) Merr masa për sensibilizimin e opinionit publik dhe për ndërgjegjësimin e tij rreth emergjencave civile dhe planifikon fonde për studime nga institucionet publike për përballimin e emergjencave civile.

f) Lidh marrëveshje me shoqata dhe organizata që ofrojnë asistencën e tyre në realizimin e detyrave në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

g) Njofton në çdo gjashtë muaj Këshillin e Ministrave për gjendjen e përgjithshme të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile.

gj) I siguron Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile të gjitha të dhënat e nevojshme për situatat emergjente dhe për rreziqet që ato përfaqësojnë.

h) Ndjek punën për krijimin dhe përdorimin e rezervave shtetërore të vëna në dispozicion nga strukturat e rezervave të shtetit, për situatat e emergjencës civile.

i) Përcakton rregullat e përdorimit të burimeve materiale e financiare në rastet e emergjencës civile.

j) Bashkërendon organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e emergjencës civile.

k) Organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel kombëtar për situatat e emergjencës civile.

l) Bashkërendon punën për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.

ll) Kontrollon zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese në rastet e emergjencave civile.

m) Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe nga ligje të tjera.

Neni 9

Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile

1. Në Ministrinë e Pushtetit Vendor krijohet dhe funksionon Departamenti i Planizimit dhe

Përballimit të Emergjencave Civile.

2. Departamenti ka për detyrë përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile.

3. Departamenti bën inspektim të vazhdueshëm për zbatimin e masave mbrojtëse kundër fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

4. Struktura, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10

Komisioni Teknik Këshillimor i specialistëve

1. Pranë Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile krijohet Komisioni Teknik Këshillimor me specialistë nga ministritë, institucionet, entet e ndryshme dhe forcat operacionale.

2. Komisioni Këshillimor thirret dhe kryesohet nga Drejtori i Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile.

3. Komisioni kryen bashkërendimin e veprimeve në fushën e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile ndërmjet autoriteteve të ndryshme dhe organizatave vullnetare.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor, përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni.

5. Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile mban regjistër për specialistët që mund të thërrasë për këshillime.

Neni 11

Ministritë

1. Çdo ministër është përgjegjës për organizimin e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në veprimtarinë që ka në përgjegjësi.

2. Ministritë kryejnë këto detyra:

a) Hartojnë planet për përgatitjen për emergjencë civile sipas llojit të veprimtarisë dhe të përgjegjësisë së tyre dhe i paraqesin këto në Ministrinë e Pushtetit Vendor për bashkërendim.

b) Zbatojnë planet dhe përcaktojnë masat për parandalimin e fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe të pasojave nga fatkeqësi të tilla në fushën e përgjegjësisë së tyre.

c) Organizojnë trajnimin dhe arsimimin në fushën e veprimtarisë së tyre, në bashkërendim dhe këshillim me Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile.

ç) Analizojnë gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në fushën e përgjegjësisë së tyre dhe njoftojnë Departamentin e Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.

Neni 12

Entet e ndryshme publike

1. Entet e ndryshme publike, kur u kërkohet nga Departamenti i Planizimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, kryejnë studime të cilat përfshijnë parashikimin, parandalimin dhe shmangien e pasojave të fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe ia paraqesin këto studime këtij Departamenti.

2. Entet publike paraqesin te ky Departament edhe rezultatet e studimeve që mund të jenë me interes për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në përgjithësi.

3. Mënyra e planifikimit dhe e përballimit të kostos përkatëse përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III
STRUKTURAT E PLANIZIMIT DHE TË PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË
NIVEL QARKU, BASHKIE DHE KOMUNE

Neni 13

Prefekti

1. Prefekti është përgjegjës për planizimin e emergjencave civile në qarkun përkatës.
2. Prefekti ka për detyrë:
 - a) të organizojë dhe të bashkërendojë punën për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në qark dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;
 - b) të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga bashkitë dhe komunat për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile;
 - c) të ndjekë dhe të kërkojë nga organet vartëse skemat e lajmërimit dhe të funksionimit të tyre;
 - ç) të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare, për sistemimin e popullsisë në raste emergjence nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;
 - d) të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale;
 - dh) të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;
 - e) të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;
 - ë) të analizojë gjendjen e planizimit të emergjencave civile dhe të njoftojë Departamentin e Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile për emergjencat civile që ndodhin në qark;
 - f) të paraqesë kërkesë për ndihmë në qarqet fqinjë dhe në instancat qendrore nëse është e nevojshme.
 - g) të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut të tij.

Neni 14

Organizimi në qark

1. Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit, ngrihet një komision i qarkut me detyrë bashkërendimin e veprimtarive të autoriteteve të qarkut dhe të organizatave vullnetare.
2. Ministri i Pushtetit Vendor përcakton përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e këtij komisioni.
3. Prefekti mban regjistër për specialistët në qark, me të cilët ai këshillohet kur gjykohet e nevojshme.

Neni 15

Shërbimi i emergjencës civile

1. Në çdo qark, nën drejtimin e prefektit, funksionon shërbimi i emergjencës civile, si pjesë përbërëse e sistemit të planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile, në përputhje me përcaktimin e pikës 13 të nenit 2 të këtij ligji.
2. Rregullat, mënyra e funksionimit, të drejtat dhe detyrat, si dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencës civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 16

Organizimi në bashki dhe në komunë

1. Kryetari i bashkisë ose kryetari i komunës është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në bashkinë dhe në komunën përkatëse.
2. Kryetari i bashkisë ose kryetari i komunës ka për detyrë:

- a) të drejtojnë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashkinë dhe në komunën përkatëse dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;
- b) të grumbullojnë dhe të përpunojnë të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë dhe komunës për zbatimin e detyrave të planizimit dhe përballimit të emergjencave civile;
- c) të organizojnë sistemin e lajmërimit të popullatës për rrezikun dhe të kujdeset për funksionimin e mjeteve të lajmërimit;
- ç) të parashikojnë burimet dhe rezervat e nevojshme për sistemin e popullatës në raste të emergjencës nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera;
- d) të realizojnë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale;
- dh) të ndjeknë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;
- e) të ndjeknë riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;
- ë) të paraqesë kërkesë për ndihmë në bashkitë dhe komunat fqinje e në qark, nëse është e nevojshme;
- f) të analizojnë gjendjen e planizimit dhe të përballimit të emergjencës civile në bashki dhe komunë dhe të njoftojnë në qark.
- g) të zbatojnë detyrat e caktuara nga strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror;
- gj) të caktojnë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile në territorin e bashkisë ose të komunës.

Neni 17

Komisioni vendor për emergjencat civile pranë bashkisë ose komunës

1. Në çdo bashki ose komunë, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë ose të komunës, krijohet komisioni vendor për emergjencat civile me detyrë bashkërendimin e veprimeve të autoriteteve të bashkisë ose komunës dhe organizatave vullnetare për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e vet.

2. Ministri i Pushtetit Vendor përcakton kriteret për përbërjen dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij komisioni.

3. Kryetari i bashkisë ose i komunës mban regjistër për specialistët në territorin e bashkisë ose komunës, me të cilin këshillohet kur është e nevojshme.

KREU IV FORCAT E NDËRHRYJES

Neni 18

Strukturat operative të emergjencës civile

Organizimi i planizimit dhe i përballimit të emergjencave civile përfshin Shërbimin e Emergjencave Civile, Bazën e Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, lloje të tjera të policisë së krijuara me ligj në varësi të emergjencës civile dhe organe të tjera të paparashikuara në këtë ligj, por që përfshihen në planet e emergjencave civile.

Neni 19

Baza e Mbrojtjes Civile

Në nivel kombëtar funksionon Baza e Mbrojtjes Civile si strukturë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo përdoret për shpëtimet e posaçme dhe operacionet e tjera urgjente si përforsim dhe për të siguruar një përgjigje të menjëhershme në emergjencat civile.

Neni 20

Përdorimi i Forcave të Armatosura për emergjencat civile

1. Kur shtrirja e një emergjence civile rritet në mënyrë të menjëhershme në ndihmë të operacioneve të shpëtimit dhe të lehtësimit në zonën e fatkeqësisë, me miratim të Kryeministrit ose të Ministrit të Mbrojtjes, mund të përdoren njësi të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas planeve të hartuara më parë në bashkëveprim me komandantët e tyre.

2. Kur njësitë e Forcave të Armatosura marrin pjesë në operacione, ato drejtohen nga komandantët e tyre sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.

Neni 21

Policia e Shtetit

1. Policia e Shtetit organizohet dhe kryen detyrat e saj në operacionet e shpëtimit dhe të lehtësimit sipas planeve të hartuara më parë.

2. Detyrat e saj përfshijnë mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe të vdekurve, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

3. Kur policia merr pjesë në operacionet e shpëtimit, forcat e saj komandohen nga eprorët e tyre, sipas detyrave që marrin nga drejtuesi i operacionit të shpëtimit.

Neni 22

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi është pjesë përbërëse e forcave operacionale në gatishmëri të përhershme dhe vepron për shuarjen e zjarreve, për kërkimin dhe shpëtimin e njerëzve në zonat e emergjencës civile dhe për lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 23

Shërbimi i ambulancës

Shërbimi i ambulancës është pjesë përbërëse e forcave operacionale dhe vepron për dhënien e ndihmës së parë në zonën e emergjencës civile dhe për transportimin e të dëmtuarve për në qendrat spitalore.

Neni 24

Shërbimi vullnetar

1. Për përballimin e emergjencave civile organizohen dhe veprojnë shërbimet vullnetare.

2. Vullnetar mund të jetë çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, që ka kryer arsimin dhe trajnimin bazë në përgjigje të situatave të emergjencës ose pranon të marrë pjesë vullnetarisht për përballimin e emergjencës civile.

3. Për përballimin e emergjencave civile pranohen vullnetarë edhe shtetas të huaj.

4. Personat që vullnetarisht kërkojnë të marrin pjesë në operacionet e shpëtimit kanë këto të drejta:

Ruhet vendi i punës.

b) Marrin pagesën e plotë nga punëdhënësi, qoftë ky edhe subjekt privat.

c) Në rast aksidenti ose humbjeje jete gjatë veprimtarisë në emergjencat civile përfitojnë pension invaliditeti, sipas dispozitave në fuqi.

Neni 25

Bashkëndimi i ndihmave

Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile bashkëndon ndihmat nga organizatat ndërkombëtare, nga organizatat joqeveritare dhe nga organizatat private vullnetare vendase dhe të huaja për përballimin e emergjencave civile.

KREU V

SUBJEKTET QË PËRFSHIHEN NË PLANIZIMIN DHE PËRBALLIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Neni 26

Detyrimi i shtetasve

1. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e Kushtetutës, detyrohet të marrë pjesë në përballimin e emergjencave civile sipas një kërkesë të Departamentit të Planizimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile, të prefektit, të kryetarit të bashkisë ose të kryetarit të komunës.

2. Detyrimi për të marrë pjesë në përballimin e emergjencave civile fillon në moshën 18 vjeç dhe përfundon në moshën 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë.

Neni 27

Përfjashtim nga detyrimi

Përfjashtohen nga detyrimi për të marrë pjesë në operacionet e ndërhyrjes së emergjencave civile shtetasit:

- a) që për arsye shëndetësore nuk mund të kryejnë detyrat e operacioneve të ndërhyrjes;
- b) gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë me moshë deri në 10 vjeç;
- c) prindër të vetëm me një fëmijë nën 10 vjeç.

Neni 28

Të drejtat e shtetasve

Shtetasit që shërbejnë në përballimin e emergjencave civile, për një kohë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se sa periudha e situatës emergjente, gëzojnë të drejtat e parashikuara në nenin 24.

Neni 29

Personat fizikë dhe juridikë

1. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët në veprimtarinë e tyre përdorin, prodhojnë, transportojnë ose magazinonë substanca të rrezikshme, detyrohen të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë me shpenzimet e veta dhe të shtetit shërbimet për përballimin e emergjencave civile në zonën e tyre të veprimtarisë.

2. Personat fizikë dhe juridikë kanë për detyrë:

- a) të hartojnë plane për situatat e emergjencës civile dhe të zbatojnë masat parandaluese në zonën e tyre të veprimtarisë;
- b) të njoftojnë personelin si dhe autoritetet e bashkisë ose të komunës për një rrezik imediat;
- c) të organizojnë, kur është e nevojshme, evakuimin e të punësuarve të tyre, dhe të venë në veprim shërbimin e tyre në përgjigje të një situatë emergjente në zonën e tyre të veprimtarisë;
- ç) të sigurojnë trajnimin për të punësuarit.

3. Këshilli i Ministrave përcakton me akt nënligjor substancat që përbëjnë rrezikshmëri për krijimin e situatave emergjente.

Neni 30
Detyrime të tjera

1. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, Departamenti i Planizimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile, prefektët dhe kryetarët e bashkive e të komunave planifikojnë dhe zbatojnë detyra për ngritjen e kulturës qytetare në përballimin e emergjencave civile.

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton dhe miraton programet përkatëse për edukimin me elementet bazë të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile.

3. Ky program fillon në arsimin 8-vjeçar dhe vazhdon deri në përfundimin e arsimit të lartë.

KREU VI
FINANCIMI

Neni 31
Buxheti i shtetit

1. Buxheti i Shtetit është burimi parësor financiar për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

2. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Pushtetit Vendor, si dhe të çdo ministrie parashikohet, zë më vete, buxheti për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Neni 32
Burime të tjera

Burime të tjera financimi mund të jenë:

- a) Buxheti i Shtetit i planifikuar për Këshillin e Ministrave;
 - b) të ardhurat e pushtetit vendor;
 - c) të ardhurat e krijuara nga shërbimi për të tretët të cilat kalojnë tërësisht në buxhetin e tyre;
 - ç) donatorë të ndryshëm;
- burime të tjera që i lejon ligji;

KREU VII
SANKSIONE

Neni 33
Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj

1. Mosrespektimi i detyrimeve që përcakton ky ligj, nga personat juridikë e fizikë, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 500 000 lekë nga strukturat operative të emergjencës civile, të cilat do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Mosrespektimi i detyrimeve që përcakton ky ligj nga ana e individëve, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 25 000 lekë.

Neni 34
E drejta për ankim

Subjekti i gjobitur mund të ankohet dhe të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit që e dënon atë me gjobë, duke respektuar kërkesat Kodit të Procedurave Administrative përsa i përket të drejtës dhe procedurave të ankimit për aktin administrativ.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35
Nxjerrja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të tij, në pajtim me parimet e përgjithshme të neneve 5, 6, 9, 14 dhe 26 të këtij ligji.

Neni 36
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dekreti nr.3824, datë 1.12.1964 i Presidiumit të Kuvendit Popullor “Për mbrojtjen civile të Republikës”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2956, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8757, datë 26.3.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8321,
DATË 2.4.1998 “PËR POLICINË E BURGJEVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë ndryshohet si vijon: “Policia Burgjeve është strukturë e armatosur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.”
- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon: “Policia e Burgjeve i kryen detyrat e veta mbështetur në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e saj.”
- Paragrafi i katërt ndryshohet si vijon: “Policia e Burgjeve gëzon të gjitha të drejtat që parashikon ligji nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.”

Neni 2

Në fund të nenit 3 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në raste të veçanta, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, veprimtaria e saj mbështetet nga Policia e Shtetit.”

Neni 3

Në nenin 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë.”

Neni 4

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

- Fjalja e parë ndryshohet si vijon: “Funksionet e punonjësve të Policisë së Burgjeve janë si më poshtë:”

- Shkronja “b” ndryshohet si vijon: “b) Specialist i policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.”

- Shkronja “d” ndryshohet si vijon: “d) Specialist i policisë në institucion.”

Neni 5

Neni 11 ndryshon si vijon:

“Policia e Burgjeve është pjesë përbërëse e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e miratuar nga Kryeministri me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë.

Efektivi i Policisë së Burgjeve përbëhet nga punonjës të rolit bazë, të mesëm, të lartë dhe madhor.

Gradat e tyre janë të njëjta me ato të Policisë së Shtetit.

Gradimi i punonjësve të rolit bazë dhe të mesëm bëhet nga Drejtori i Policisë së Burgjeve.

Gradat e punonjësve të rolit të lartë jepen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kurse gradat e rolit madhor jepen me dekret të Presidentit të Republikës, në bazë të propozimit të Ministrit të Drejtësisë.

Për gradimin e punonjësve të rolit bazë dhe të mesëm ngrihet pranë Ministrisë së Drejtësisë një komision këshillimor, përbërja dhe funksionimi i të cilit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjala “policëve” zëvendësohet me fjalët “punonjësve të rolit bazë.”.

- Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Fituesit e konkursit emërohen punonjës policie të rolit bazë. Titullimi dhe gradimi i tyre bëhet pas mbarimit të kursit përkatës në Shkollën e Policisë së Burgjeve.”

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjala “oficerëve” zëvendësohet me fjalët “punonjësve të tjerë”.

- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Emërimi dhe shkarkimi në funksionet, sipas shkronjave “ç”, “d” dhe “dh” të nenit 5 të këtij ligji bëhen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve me propozimin e Drejtorit të Policisë së Burgjeve, kurse sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 5 të këtij ligji bëhen nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.”

Neni 8

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjala “oficerëve” zëvendësohet me fjalën “punonjësve” dhe fjala “kolonel” me fjalët “punonjës së rolit të lartë ose të barasvlefshëm me të”.

- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Drejtori i Policisë së Burgjeve emërohet nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.”

Neni 9

Neni 16 ndryshohet si vijon:

“Për dhënien ose heqjen e gradave zbatohen të njëjtat kritere që përcaktohen në ligjin nr.8643, datë 20.7.2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit.”

Neni 10

Neni 18 ndryshohet si vijon:

“Procedimi disiplinor

1. Masat disiplinore jepen nga eprori i drejtpërdrejtë dhe, në çdo rast, i njoftohen punonjësit të policisë. Në çdo rast punonjësi detyrohet të zhdëmtojë dëmin e shkaktuar sipas dispozitave në fuqi.

2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i njoftohet me shkrim të interesuarit dhe shënohet në dosjen vetjake.

3. Dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhet sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t’u vënë në dijeni, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur.”

Neni 11

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1

Ankimi

1. Në çdo rast punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit është marrë masë disiplinore, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim brenda 10 ditësh tek titullari i institucionit.

2. Kur titullari i institucionit e gjykon të pabazuar dhënien e masës disiplinore, nuk e miraton atë. Në rast të miratimit të masës disiplinore, punonjësi i policisë ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim, brenda 10 ditëve te Komisioni Disiplinor. Titullari i institucionit mund të vendosë pezullimin nga detyra të punonjësit të policisë.

3. Komisioni Disiplinor, kur e gjen të bazuar, vendos lënien në fuqi të masës disiplinore, ose i propozon titullarit të institucionit për ta rishikuar masën e dhënë.

4. Vendimi i Komisionit Disiplinor për lënien në fuqi të masës disiplinore është i formës së prerë, me përjashtim të masave disiplinore të parashikuara në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 17 të këtij ligji, që hyjnë në fuqi me miratim të organit përkatës për emërimin ose dhënien e gradës përkatëse. Miratimi jepet brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit nga Komisioni Disiplinor.

5. Për masat disiplinore të ankimuara, afatet e shuarjes fillojnë nga data kur vendimi i titullarit ka marrë formë të prerë.

6. Përbërja dhe funksionimi i Komisionit Disiplinor përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 12

Pas nenit 18/1 shtohet neni 18/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/2

Heqja dhe shuarja e masës disiplinore

1. Gjatë periudhës në të cilën ndaj punonjësit është marrë masë disiplinore, ndërpritet ecja e afateve që lidhen me fitimin e të drejtave të parashikuara për punonjës të Policisë së Burgjeve, duke përjashtuar vjetërsinë në shërbim.

2. Në raste të veçanta, kur i ndëshkuari kryen akte përkushtimi në detyrë, heqja e masës disiplinore mund të bëhet nga titullari para afatit.

3. Masat disiplinore, me përjashtim të pikës 6 të nenit 17 të këtij ligji, mund të shlyhen nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre ndaj punonjës të policisë nuk është marrë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.”

Neni 13

Pas nenit 18/2 shtohet neni 18/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/3

Ankimi në gjykatë

Kundër vendimit të formës së prerë për dhënien e masave disiplinore, të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile.”

Neni 14

Neni 20 ndryshohet si vijon:

“Marrëdhëniet në punë për punonjës të tjerë të administratës së Policisë së Burgjeve rregullohen në përputhje me Kodin e Punës.”

Neni 15

Në të gjitha dispozitat e ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 fjalët “Policia e Rendit” zëvendësohen me fjalët “Policia e Shtetit”.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2957, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8758, datë 26.3.2001

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8328, DATË 16.4.1998 “PËR TË DREJTAT DHE
TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Neni 22 i ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ndryshohet si vijon:

“Neni 22
Policia e Burgjeve

Policia e Burgjeve është strukturë e armatosur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Veprimtaria e kësaj policie rregullohet nga ligji nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2958, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani.**

L I G J
Nr.8759, datë 26.3.2001

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN
NDËRKOMBËTARE PËR ASISTENCË TË NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE PËR
PARANDALIMIN, HETIMIN DHE GODITJEN E SHKELJEVE DOGANORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën ndërkombëtare për asistencë të ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2960, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

KONVENTA

NDËRKOMBËTARE MBI ASISTENCËN RECIPROKE ADMINISTRATIVE PËR
PARANDALIMIN, HETIMIN DHE GODITJEN E SHKELJEVE DOGANORE

(NAIROBI, 9 QERSHOR 1977)

HYRJE

PALËT KONTRAKTUESE në Konventën në fjalë, themeluar nën mbikëqyrjen e Këshillit të Kooperimit Doganor,

Duke marrë parasysh që shkeljet ndaj Ligjit Doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, sociale dhe fiskale të Shteteve dhe interesave legjitime të tregtisë,

Duke marrë parasysh se aksionet ndaj shkeljeve doganore mund të kryhen më efektivisht nëpërmjet kooperimit ndërmjet Administratave Doganore, dhe se ky kooperim është një nga qëllimet e Konventës duke themeluar një Këshill Kooperimi Doganor,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

(a) termi “Ligj Doganor” do të thotë gjithë dispozitat statuore ose rregullatore që janë në fuqi ose administrohen nga Administrata Doganore lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitin e mallrave;

(b) termi “Shkelje Doganore” do të thotë çdo thyerje ose përpjekje për thyerje të ligjeve doganore;

(c) termi “Mashttrim Doganor” do të thotë një shkelje doganore nga e cila një person mashtron doganat dhe në këtë mënyrë i shmanget pjesërisht ose tërësisht pagesave të detyrimeve dhe taksave të importit ose eksportit ose zbatimit të kufizimeve dhe ndalimeve të parashtruara në Kodin Doganor ose përfiton ndonjë avantazh në kundërshtim me ligjin Doganor;

(d) termi “kontrabandë” do të thotë mashtrimi doganor që konsiston në lëvizjen e mallrave përmes një kufiri Doganor në një mënyrë klandestine;

(e) termi “detyrime dhe taksa doganore” do të thotë detyrime Doganore dhe detyrime të tjera, taksa, kuota ose pagesa të tjera të cilat mblidhen gjatë ose në lidhje me importin ose eksportin e mallrave, por pa përfshirë kuotat ose pagesat e tjera të cilat janë të kufizuara më shumë, afërsisht me koston e shërbimeve të tjera;

(f) termi “person” do të thotë si personat fizikë ashtu dhe ata juridikë, në rastet kur konteksti nuk kërkon diçka tjetër;

(g) termi “Këshill” do të thotë organizata e ngritur nga konventa e cila themelon një “Këshill të Kooperimit Doganor”, kryer në Bruksel më 15 dhjetor 1950;

(h) termi “Komiteti Teknik Permanent” do të thotë Komiteti Teknik Permanent i Këshillit;

(i) termi “ratifikim” do të thotë ratifikim, pranim ose aprovim.

KREU II

Neni 2

Fusha e veprimit të Konventës

1. Palët Kontraktuese të lidhura nga një ose më tepër Anekse të kësaj Konvente bien dakord se Administratat e tyre Doganore do të përballojnë asistencë reciproke ndaj njëra-tjetrës me synim parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese mund të kërkojë asistencë të ndërsjellë siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij Neni gjatë çdo lloj investigimi ose në lidhje me ndjekjet penale ose administrative që ndërmerren nga një Palë Kontraktuese. Nëse Administrata Doganore nuk e kryen vetë këtë ndjekje, ajo mund të kërkojë asistencë të ndërsjellë vetëm brenda limiteve të kompetencës së vet në këtë proces. Në mënyrë të ngjashme, nëse ndjekja kryhet në vendin e administratës që i kërkohet asistencë, kjo e fundit jep asistencën e kërkuar brenda limiteve të kompetencave të veta në këtë proces.

3. Asistenca e ndërsjellë siç përshkruhet në paragrafin 1 të këtij Neni nuk do të zgjerohet në kërkesa për arrestimin e personit ose grumbullimin e detyrimeve, taksave, pagesave, gjobave ose parave të tjera në interes të Palës Kontraktuese.

Neni 3

Nëse njëra Palë Kontraktuese konsideron se asistenca e kërkuar bie në kundërshtim me sovranitetin, sigurinë ose interesa të tjera themelore kombëtare ose dëmton interesat legjitime komerciale të ndonjë kompanie, publike ose private, ajo mund të mohojë dhënien e kësaj asistence ose ta japë sipas disa kushteve ose kërkesave të përcaktuara.

Neni 4

Nëse Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese kërkon asistencë e cila në vetvete nuk do të ishte në gjendje ta jepte këtë asistencë nëse do t'i kërkohej nga një Palë Kontraktuese, duhet ta theksojë këtë në kërkesën e vet. Përgjigjia për këtë kërkesë do të varet nga konsiderata e Palës së Kërkuar Kontraktuese.

KREU III

Neni 5

Procedura e asistencës së përgjithshme

1. Çdo inteligjencë, dokument ose informacione të tjera të komunikuar ose të përfituara në këtë Konventë:

(a) do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në këtë Konventë, duke përfshirë përdorimin në procedimet penale ose administrative, dhe varur nga kushtet e vëna nga Administrata Doganore e cila i ka dërguar; dhe

(b) do të ketë në vendin marrës të njëjtën mbrojtje lidhur me konfidencialitetin dhe sekretin zyrtar; siç aplikohet në atë vend për të njëjtat lloje dokumentesh, inteligjence dhe informacione të tjera të përfituara në territorin e vet.

2. Kjo lloj inteligjence, dokumenti ose informacioni mund të përdoret për qëllime të tjera vetëm me aprovimin e shkruar të Administratës Doganore që i ka dhënë dhe e kushtëzuar nga kufizimet e përcaktuara nga ajo administratë, si dhe nga dispozitat e paragrafit 1 (b) të këtij Neni.

Neni 6

1. Komunikimi mes Palëve Kontraktuese dhënë nga kjo Konventë do të kryhet direkt ndërmjet Administratave Doganore. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do të emërojnë shërbimet ose nëpunësit për këto ndërlidhje dhe do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit për emrat dhe Adresat e këtyre Shërbimeve ose Personave. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë këtë informacion Palëve të tjera Kontraktuese.

2. Administrata Doganore e Palës së Kërkuar Kontraktuese, kushtëzuar nga rregullat dhe ligjet në fuqi në territorin e vet, do të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave për asistencë.

3. Administrata Doganore e Palës së Kërkuar Doganore do t'i përgjigjet kërkesës për asistencë, sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 7

1. Kërkesa për asistencë, sipas kësaj Konvente, duhet të kryhet normalisht me shkrim; kjo duhet të përmbajë informacionin e kërkuar dhe të shoqërohet nga dokumente të tilla që konsiderohen të dobishme.

2. Kërkesa me shkrim duhet të bëhet në një gjuhë të pranueshme nga Palët Kontraktuese të interesuara. Çdo lloj dokumenti shoqërues i kërkesës të përkthehet në një gjuhë reciprokisht të pranuar, nëse është e nevojshme.

3. Palët Kontraktuese do të pranojnë, në çdo rast, kërkesat për asistencë dhe dokumentet shoqëruese në anglisht dhe frengjisht, shoqëruar nga një përkthim në anglisht ose frengjisht.

4. Kur, për arsye urgjence të veçantë, kërkesat për asistencë nuk janë bërë me shkrim, Pala e Kërkuar Kontraktuese mund të kërkojë konfirmim me shkrim.

Neni 8

Çdo shpenzim që rrjedh nga kjo Konventë lidhur me ekspertë ose dëshmitarë do të përballohet nga Pala që bën kërkesën. Palët Kontraktuese do të heqin dorë nga çdo kërkesë për rimbursim ose çdo kosto tjetër që rrjedh nga zbatimi i kësaj Kontrate.

KREU IV

Neni 9

Dispozita të ndryshme

Këshilli dhe Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do të koordinojnë shërbimet lidhur me parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore për të mirëmbajtur lidhje personale dhe direkte me synim nxitjen e synimeve të përgjithshme të kësaj Konvente.

Neni 10

Për qëllimet e kësaj Konvente çdo Aneks ose Anekse të pranuar nga Palët Kontraktuese do të konsiderohen pjesë integrale të kësaj Konvente, dhe në lidhje me atë Palë Kontraktuese, çdo referencë ndaj kësaj Konvente duhet të përmbajë dhe referencën ndaj Aneksit ose Anekseve.

Neni 11

Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të shmangin aplikimin e çdo lloj marrëveshjeje tjetër të zgjeruar të ndërsjellë, që mund të kenë ose mund të lidhin në të ardhmen Palët Kontraktuese.

KREU V

Neni 12

Roli i Këshillit dhe Komiteti Teknik Permanent

1. Këshilli do të jetë përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e kësaj Konvente, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Për këtë qëllim Komiteti Teknik Permanent, nën autoritetin e Këshillit dhe në përputhje të çdo udhëzimi dhënë nga Këshilli, do të ketë këto funksione:

(a) T'i kalojë Këshillit propozime për ato amendamente të kësaj Konvente që mund të konsiderohen të nevojshme.

(b) Të furnizojë me opinione lidhur me interpretimin e dispozitave të Konventës.

(c) Të mirëmbajë marrëdhënie me organizatat e tjera ndërkombëtare të interesuara, dhe veçanërisht me organet kompetente të Kombeve të Bashkuara, me UNESKO-n dhe me Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale/Interpol, për sa i takon aksioneve kundër trafikut ilegal për lëndët narkotike dhe substancat psikotrope, dhe aksionet kundër trafikut ilegal për veprat e artit, antikitetet dhe pasuritë e tjera kulturore.

(d) Të kryejë çdo aksion me synim zgjerimin e synimeve të përgjithshme të Konventës dhe veçanërisht për të studiuar metoda të reja dhe procedura për të lehtësuar parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore, për të organizuar takime etj.

(e) Të kryejë aksione të tilla të drejtuara nga Këshilli në lidhje me dispozitat e Konventës.

Neni 13

Për qëllime votimi në Këshill dhe në Komitetin Teknik Permanent, çdo Aneks do të merret si Konventë e veçantë.

KREU VI

Neni 14

Dispozita Finale

Çdo mosmarrëveshje mes dy ose më tepër Palësh Kontraktuese, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të zgjidhet me negociime midis tyre.

Neni 15

1. Çdo shtet anëtar i Këshillit dhe çdo shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara ose i agjencive të saj të specializuara mund të bëhet Palë Kontraktuese e kësaj Konvente (sipas amendamentit të Protokollit i cili hyri në fuqi më 27 Korrik 1989):

(a) duke e nënshkruar atë pa rezerva ratifikimi;

(b) duke depozituar një instrument të ratifikimit, pasi e ka nënshkruar atë në bazë të ratifikimit; ose

(c) duke hyrë në të.

2. Kjo Konventë do të jetë e hapur deri më 30 Qershor 1978 për nënshkrim në Drejtorinë e Këshillit në Bruksel nga shtetet e referuara në paragrafin 1 të këtij Neni. Më pas do të jetë e hapur për pranimin e tyre.

3. Çdo shtet i referuar në Paragrafin 1 të kësaj Konvente duhet, në kohën e ratifikimit, nënshkrimit ose hyrjes në këtë Konventë të specifikojë Aneksin ose Anekset që ai pranon, duke qenë e nevojshme të pranojë të paktën një Aneks. Në vazhdim, duhet të njoftojë Sekretarinë e Përgjithshme të Këshillit se pranon një ose më tepër Anekse.

4. Instrumentet e ratifikimit ose pranimit duhet të depozitohen në Sekretarinë e Përgjithshme të Këshillit.

5. Doganat ose bashkimet ekonomike mundet, së bashku me Vendet e Tyre Anëtare ose në çdo kohë që Vendet Anëtare të tyre të jenë bërë Palë Kontraktuese në këtë Konventë, gjithashtu, të bëhen Palë Kontraktuese në këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e paragrafeve 1,2 dhe 3 të këtij Neni. Megjithatë, këto Unione nuk do të kenë të drejtën për të votuar.

Neni 16

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pesë nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të Nenit 15 ta kenë nënshkruar Konventën pa rezerva ratifikimi ose të kenë depozituar instrumentet e ratifikimit ose të hyrjes.

2. Për çdo Palë Kontraktuese e cila ka nënshkruar Konventën pa rezervime ose ratifikime, e ka ratifikuar ose ka hyrë në të pasi pesë shtete kanë ratifikuar ose hyrë në të pa rezerva ose ratifikim, ose kanë depozituar instrumentet e ratifikimit ose të pranimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi Pala Kontraktuese në fjalë ta ketë nënshkruar atë pa rezerva ose ratifikime ose të ketë depozituar instrumentet e veta të pranimit ose të ratifikimit.

3. Çdo aneks i kësaj Konvente do të hyjë në fuqi tre muaj pasi dy shtete të kenë pranuar Aneksin. Për çdo Palë Kontraktuese e cila në vazhdim pranon një Aneks, pasi dy shtete ta kenë pranuar atë, ky Aneks do të hyjë në fuqi tre muaj pasi Pala Kontraktuese në fjalë të ketë njoftuar pranimin e këtij Aneksi. Asnjë Aneks nuk do të hyjë në fuqi për një Palë Kontraktuese përpara se Konventa të ketë hyrë në fuqi në atë Vend Kontraktues.

Neni 17

1. Çdo Shtet mundet, që në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente pa rezerva ose ratifikime ose pasi ka depozituar instrumentet e ratifikimit ose pranimit, ose në çdo kohë pas kësaj të deklarojë nëpërmjet një njoftimi tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit se kjo Konventë do të zgjerohet në gjithë territorin ose një pjesë të territorit për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai Shtet është përgjegjës. Ky njoftim do të ketë efekt tre muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit. Megjithatë, Konventa nuk do të aplikohet në territoret e përmendura në njoftim, përpara se Konventa të ketë hyrë në fuqi në shtetin në fjalë.

2. Çdo Shtet i cili ka bërë njoftim sipas paragrafit 1 të këtij Neni, duke e zgjeruar këtë Konventë në territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit, sipas procedurave të Nenit 19 të kësaj Konvente, se territori në fjalë nuk do të vazhdojë ta zbatojë më këtë Konventë.

Neni 18

Çdo Palë Kontraktuese do të konsiderohet se ka hyrë ose ka pranuar gjithë dispozitat e Konventës ose Aneksit lidhur me të, përjashtuar rastet kur në momentin e hyrjes në Konventë ose pranimit të veçantë të një Aneksi, ose në çdo kohë pas kësaj, ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit për çfarëdo rezerve lidhur me dispozitat të cilat nuk mund t'i aplikojë. Duhet të ndërmarrë ekzaminimin periodik të dispozitave për të cilat ka pasur rezerva dhe të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, lidhur me anulimin e këtyre rezervave.

Neni 19

1. Kjo Konventë është e një kohëzgjatjeje të pacaktuar, por çdo Palë Kontraktuese mund të largohet prej saj (denoncojë) në çdo kohë pas datës së hyrjes në fuqi, sipas Nenit 16 më sipër.

2. Denoncimi duhet të njoftohet nëpërmjet një instrumenti të shkruar, depozituar tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së dokumentit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

4. Dispozitat e paragrafeve 2 dhe 3 të këtij Neni, gjithashtu do të aplikohen në respekt të

Anekseve të kësaj Konvente, duke pasur mundësi që çdo Palë e cila ka hyrë në to, të ketë të drejtën në çdo datë pas hyrjes në fuqi, sipas Nenit 16 të kësaj Konvente, të distancohet nga pranimi i një ose më tepër Anekseve. Çdo Palë Kontraktuese, e cila ka deklaruar tërheqjen nga pranimi i gjithë Anekseve, do të konsiderohet se ka denoncuar Konventën.

5. Çdo Palë Kontraktuese e cila denoncon Konventën ose tërheq pranimin e një ose më tepër prej Anekseve, do të konsiderohet e lidhur me dispozitat e Nenit 5 të kësaj Konvente, për aq kohë sa ajo do të ketë në dispozicion çfarëdolloj inteligjence, dokumenti ose informacioni tjetër të marrë nën këtë Konventë.

Neni 20

1. Këshilli mund të rekomandojë amendamente në këtë Konventë.

2. Teksti i çdo amendamenti të rekomanduar në mënyrë të tillë do t'i komunikohet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, gjithë Palëve Kontraktuese në këtë Konventë, Shteteve të tjera Nënshkruese dhe atyre Shteteve anëtare të Këshillit që nuk janë Palë Kontraktuese në këtë Konventë.

3. Çdo amendament i propozuar dhe i komunikuar sipas paragrafit të mësipërm do të hyjë në fuqi në respekt të të gjitha Palëve Kontraktuese, tre muaj pas skadencës së periudhës prej dy vjetësh që ndjekin datën e komunikimit të amendamenteve të propozuara, kur gjatë periudhës në fjalë nuk i janë komunikuar kundërshtime për propozimet e paraqitura Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit nga ndonjë shtet, i cili është Palë Kontraktuese.

4. Nëse Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit i është komunikuar ndonjë kundërshtim për amendamentet e propozuara nga ndonjë Shtet që është Palë Kontraktuese përpara skadencës së periudhës prej dy vjetësh, specifikuar në paragrafin 3 të këtij Neni, amendamentet do të konsiderohen si të papranuara dhe nuk do të kenë efekt.

Neni 21

1. Çfarëdo Palë Kontraktuese e cila ratifikon ose hyn në këtë Konventë do të konsiderohet se ka pranuar çdo amendament në fjalë i cili ka hyrë në fuqi në datën e depozitimit të instrumenteve të vet të ratifikimit ose pranimi.

2. Çdo Palë Kontraktuese, e cila pranon një Aneks, do të konsiderohet se ka pranuar çdo amendament lidhur me këtë Aneks i cili ka hyrë në fuqi në datën në të cilën ka njoftuar këtë pranim tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

Neni 22

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të njoftojë Palët Kontraktuese në këtë Konventë, Shtetet nënshkruese, Shtetet anëtare të Këshillit të cilat nuk janë Palë Kontraktuese në Konventë dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi:

- a) nënshkrimin, ratifikimin, pranimin dhe njoftimin sipas Nenit 15 të kësaj Konvente;
- b) datën e hyrjes në fuqi të Konventës dhe të gjithë Anekseve, në përputhje me Nenin 16;
- c) njoftimin e marrë në përputhje me Nenin 17;
- d) denoncimin, sipas Nenit 19;
- e) çdo amendament që konsiderohet të jetë pranuar, në përputhje me Nenin 20 dhe datën e hyrjes në fuqi.

Neni 23

Pas hyrjes në fuqi, kjo Konventë do të regjistrohet në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara, në përputhje me Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Dëshmitarë për sa më sipër, të nënshkruarit, të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Kryer në Nairobi, më 9 Qershor 1977, në gjuhën angleze dhe frënge, duke qenë të dyja tekstet barazisht autentike, në një origjinal të vetëm i cili do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i cili do t'u transmetojë kopje të certifikuara gjithë Shteteve të përmendura në paragrafin 1 të Nenit 15 të kësaj Konvente.

ANEKS I

Asistencë nga një Administratë Doganore, sipas iniciativës së vet

1. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese, me iniciativën e vet, do t'i komunikojë Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, e cila ka interes, çfarëdolloj informacioni të një natyre thelbësore, e cila është gjetur gjatë aktivitetit të vet normal dhe që jep shkaqe të mira për të besuar se në territorin e një pale Kontraktuese do të kryhet një shkelje serioze doganore. Informacioni i cili do të komunikohet të përmbajë, veçanërisht, lëvizjen e personave, mallrave dhe mjeteve të transportit.

2. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese do t'i komunikojë kur e sheh të përshtatshme, sipas iniciativës së vet Administratës Doganore të Palës tjetër Kontraktuese dokumente, raporte, regjistrime evidencash ose kopje të certifikuara lidhur me të në mbështetje të informacionit të transmetuar sipas paragrafit 1.

3. Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese, me iniciativën e vet do t'i komunikojë Administratës Doganore të një Pale tjetër Kontraktuese e cila ka interes direkt, çdolloj informacioni i cili duket se është i një interesi material për të, lidhur me shkeljet doganore, dhe, veçanërisht, lidhur me mjetet ose metodat e reja që përdoren për të kryer këto lloj shkeljesh.

ANEKS II

Asistencë, sipas kërkesës, lidhur me përcaktimin e detyrimeve dhe taksave të importit ose eksportit

1. Sipas kërkesës së një Administrate Doganore të një Pale Kontraktuese e cila ka arsye të forta për të besuar se në vendin e vet është kryer shkelje serioze doganore, Administrata Doganore e Palës Kontraktuese të cilës i është kërkuar asistencë do të komunikojë gjithë informacionin i cili mund të ndihmojë për të siguruar përcaktimin e saktë të detyrimeve dhe taksave të importit ose eksportit.

2. Një Palë Kontraktuese do të konsiderohet se ka përmbushur detyrimet lidhur me këtë, nëse p.sh. ka komunikuar, siç duhet në përgjigje të një kërkesë informacionin e mëposhtëm ose dokumentet e nevojshme për të:

a) lidhur me vlerën e mallrave për qëllime doganore: faturat tregtare të paraqitura në doganat e vendit të eksportit ose importit ose kopje të këtyre faturave, të certifikuara ose jo nga Dogana, siç mund ta kërkojnë rrethanat, dokumentet që tregojnë çmimet momentale të importit ose eksportit, kopje të deklaratës së vlerës të kryer në importimin ose eksportimin e mallrave, katalogët e tregut, listat e çmimeve, etj., të publikuara në vendin e eksportit ose të importit;

b) lidhur me klasifikimin tarifor të mallrave, analizat e kryera nga shërbimet laboratorike për të vendosur klasifikimin tarifor të mallrave, përshtatjet tarifor të deklaruar gjatë importit ose eksportit;

c) lidhur me origjinën e mallrave, deklaratën e origjinës kryer gjatë eksportit, kur kërkohet një deklaratë e tillë, statusin Doganor të mallrave në vendin e eksportimit (tranzit doganor, magazinë doganore, praninë e përkohshme, zonë e lirë, qarkullim i lirë, eksport për rikthim, etj).

ANEKS III

Asistencë, sipas kërkesës, lidhur me kontrollet

Me kërkesë të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese do t'i komunikojë asaj Administrate Doganore informacion lidhur me çështjet e mëposhtme:

a) Autenticitetin e dokumenteve zyrtare të prodhuar në mbështetje të një deklarate Doganore që i është dhënë Autoriteteve Doganore të Palës Kërkuese.

b) Nëse mallrat e importuara në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i një Pale tjetër Kontraktuese.

c) Nëse mallrat e eksportuara nga territori i Palës Kërkuese Kontraktuese kanë qenë importuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Palës Kontraktuese që i kërkohet informacion.

ANEKS IV

Asistencë, sipas kërkesës, lidhur meurvejimet

Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, për aq sa i lejon kompetenca dhe mundësia, do të kryejëurvejime special për një periudhë të caktuar kohe mbi:

a) lëvizjet, veçanërisht për hyrjet brenda dhe daljet jashtë territorit të vet, për persona të veçantë, për të cilët ka arsye të besohet se janë lidhur profesionalisht apo vazhdimisht me shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

b) lëvizjen e mallrave të veçanta të cilat janë raportuar nga Administrata Doganore e Palës Kontraktuese Kërkuese se shkaktojnë rritje të Trafikut ilegal të importit në drejtim ose nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) vende të veçanta ku janë grumbulluar mallra, të cilat japin shkaqe për të arsyetuar se ato mallra do të përdoren për një import të paligjshëm në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese

d) mjete lëvizëse të veçanta, anije, avione ose mjete të tjera transporti për të cilat besohet me arsye se mund të përdoren për të kryer një shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

dhe do t'i dërgojë një raport për këto Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

ANEKS V

Kërkime dhe njoftime, sipas kërkesës, për interes të Palës tjetër Kontraktuese

1. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga Ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vet, do të bëjë kërkime për të marrë të dhënat lidhur me një shkelje Doganore nën hetim në territorin e Palës Kërkuese Kontraktuese, dhe do të marrë deklarata nga çdo person i konsideruar i lidhur me këtë shkelje ose nga dëshmitarë ose ekspertë, dhe do t'ua dërgojë rezultatet e kërkimeve, si dhe dokumente ose evidenca të tjera, Administratës Doganore të Palës Kërkuese Kontraktuese.

2. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga Ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vet, do të njoftojë personat që lidhen me këtë, dhe që janë rezidentë në territorin e vet ose do t'i ketë njoftuar nëpërmjet autoriteteve kompetente për çfarëdolloj aksioni ose vendimi të marrë nga Pala Kontraktuese Kërkuese, lidhur me çfarëdolloj çështje që ndodhet brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente.

ANEKS VI

Paraqitja përpara gjyqit ose Tribunaleve jashtë shtetit e zyrtarëve të Doganës

Kur nuk mjafton që evidenca të dërgohet vetëm në formën e një deklarate me shkrim, sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, për aq sa i lejon mundësia, do të autorizojë nëpunësit e vet të paraqiten përpara gjyqit ose Tribunaleve në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese si dëshmitarë ose ekspertë në një çështje të shkeljeve doganore. Kërkesa për paraqitje do të specifikojë, se veçanërisht në çfarë çështje dhe në çfarë pozicioni do të dëgjohet ky nëpunës. Administrata Doganore e Palës Kontraktuese që

pranon kërkesën, do të deklarojë, në autorizimin e paraqitjes, çfarëdo limiti në të cilat nëpunësit e vet do të detyrohen të japin evidencat.

ANEKS VII

Prezenca e Zyrtarëve të Doganës së një Pale Kontraktuese në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese

1. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese që po investigon për një shkelje të caktuar doganore, Administrata Doganore e një Pale tjetër Doganore, kur e sheh të nevojshme, do të autorizojë zyrtarë të caktuar specifikisht, të deleguar nga Pala Kontraktuese Kërkuese, të konsultohen në zyrat e veta me librat e nevojshëm, regjistrat dhe dokumentet e tjera ose të dhënat e ruajtura në këto zyra, të marrin kopje të tyre, ose pjesë të informacioneve ose partikularëve që lidhen me atë shkelje.

2. Në aplikim të dispozitave të paragrafit 1 më sipër zyrtarëve të Palës Kontraktuese Kërkuese do t'i jepet gjithë asistenca e mundshme dhe bashkëpunimi për të lehtësuar investigimet e tyre.

3. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kur konsiderohet e përshtatshme, do të autorizojë zyrtarët e administratës kërkuese të jenë prezent në territorin e Palës Kontraktuese që i kërkohet asistencë, lidhur me kërkimet ose raportin zyrtar për një shkelje Doganore që i intereson Palës Kontraktuese.

ANEKS VIII

Pjesëmarrje në investigimet jashtë

Kur shihet e përshtatshme nga të dyja Palët Kontraktuese, zyrtarët e Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së një Pale tjetër Kontraktuese, do të marrin pjesë në investigimet jashtë që kryen në territorin e asaj Pale tjetër Kontraktuese.

ANEKS IX

Grumbullimi i informacionit

1. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do t'i komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit informacionin e specifikuar më poshtë, për aq kohë sa kjo përbën interes ndërkombëtar.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të institucionalizojë dhe mbajë vazhdimisht një indeks qendror për informacionin e komunikuar atij nga Palët Kontraktuese dhe do të përdorë informacion prej saj për të përgatitur përmbledhje dhe studime mbi tendencat e reja dhe të rinovuara mbi Mashtimet Doganore. Ai, periodikisht, do ta rifreskojë indeksin për të eliminuar informacione të cilat, për mendimin e tij, janë të panevojshme ose kanë kaluar kohën.

3. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit dhe, kushtëzuar nga dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe këtij Aneksi, do t'i japin Sekretarit të Përgjithshëm informacione të tilla që mund të jenë të nevojshme për të përgatitur këto përmbledhje dhe studime të përmendura në paragrafin 2 të këtij Aneksi.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të shpërndajë tek nëpunësit ose shërbimet e emëruara nga Palët Kontraktuese informacion specifik që përmbahet në indeksin qendror, në atë sasi që ai e konsideron këtë shpërndarje të dobishme, si dhe përmbledhje dhe studime të përmendura në paragrafin 2 të këtij Aneksi.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, sipas kërkesës, do të furnizojë Palët Kontraktuese me çfarëdo informacioni tjetër që ai ka në dispozicion, sipas këtij Aneksi.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të respektojë çdo kufizim që Pala Kontraktuese ka kërkuar prej tij kur i ka dhënë informacionin.

7. Një Palë Kontraktuese që ka dërguar informacion ka të drejtë të kërkojë që në vazhdim

ky të fshihet nga indeksi qendror dhe nga çfarëdolloj regjistri të themeluar nga Palët Kontraktuese me të cilat ka komunikuar dhe se nuk do të përdoret më ky informacion.

PJESA I: PERSONAT

Seksioni I. Kontrabanda

8. Njoftimet sipas këtij Seksioni do të përmbajnë informacion lidhur me:

- a) personat e dënuar përfundimisht për kontrabandë; dhe,
- b) kur është e përshtatshme, personat e dyshuar për kontrabandë ose të kapur në akt kontrabande në territorin e Palës Kontraktuese, duke bërë njoftimin, megjithëse procesi penal mund të mos jetë kompletuar, e cila nënkupton se kur Palët Kontraktuese nuk njoftojnë emrat dhe përshkrimin e personave të implikuar, sepse kjo ndalohej nga ligjet e tyre kombëtare, ata gjithsesi duhet të bëjnë një njoftim i cili të përmbajë sa më shumë nga të dhënat që janë në listë në këtë Seksion.

Në parim, informacioni i njoftuar duhet të kufizohet në shkeljet që kanë rezultuar ose kanë çuar në burgosje ose gjoba që tejkalojnë ekuivalentin e 2000 US \$.

9. Informacioni i dërguar të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur faktet e mëposhtme:

(A) Person fizik

- a) Mbiemri;
- b) Emri;
- c) Emri i dhënë (nëse përdoret);
- d) Pseudonimi;
- e) Profesionin;
- f) Adresa;
- g) Datëlindja dhe Vendlindja
- h) Shtetësia/Kombësia;
- ij) Vendi i rezidencës dhe vendet e vizituara në 12 muajt e fundit;
- k) Tipi dhe numri i letrave të identifikimit, duke përfshirë vendin dhe datën e lëshimit

I. Përshkrimi fizik

1. Seksi;
2. Gjatësia;
3. Pësia;
4. Konstruktin;
5. Flokët;
6. Sytë;
7. Kompleksitetin;
8. Shenja dalluese ose femërore;

m) Të dhëna të përmbledhura për shkeljen (duke përfshirë të dhëna për tipin, sasinë dhe origjinën e mallrave që janë përfshirë në shkelje, prodhuesi, transportuesi dhe ngarkuesi) dhe kushtet të cilat kanë çuar në zbulimin;

n) Natyra dhe sasia e dënimeve ose gjobave të vëna;

o) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë gjuhët që janë folur dhe (nëse është e mundur) ndonjë shkelje të kaluar të regjistruar;

p) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

(B) Personat juridikë (firmat)

- a) Emri;
- b) Adresa;
- c) Emrat e drejtuesve kryesorë ose nëpunësve të firmës kundër të cilëve është kryer ndjekje ligjore, dhe nëse është e mundur të identifikohen të dhëna, siç tregohet në Pjesën (a), Pikat (A)-(1).
- d) Kompania ndërkombëtare e lidhur;
- e) Natyra e biznesit që kryen;
- f) Natyra e shkeljes;

- g) Të dhëna për shkeljen (duke përfshirë prodhuesin, transportuesin dhe dërguesin) dhe kushtet që çuan në zbulimin e shkeljes;
 - h) Madhësia e dënimit;
 - ij) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë (nëse ka mundësi) ndonjë shkelje tjetër e regjistruar;
 - k) Pala Kontraktuese që dërgon informacionin (duke përfshirë numrin e referencës);
10. Si rregull i përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të shpërndajë informacionin lidhur me personat fizike të paktën në vendet e shtetësisë kombësisë dhe rezidencës, si dhe në vendet që personi fizik në fjalë ka vizituar gjatë 12 muajve të fundit.

Seksioni II. Mashtrime Doganore të tjera veç kontrabandës

11. Njoftimet nën këtë Seksion do të përmbajnë informacion lidhur me:

- a) personat përfundimisht të dënuar për shkelje doganore të tjera veç kontrabandës;
- b) kur është e mundur, personat e dyshuar për mashtrime të tilla, edhe ata për të cilët procesi penal nuk ka përfunduar ende, që duhet kuptuar se kur Palët Kontraktuese mohojnë dhënien e emrave dhe përshkrimeve të personave të implikuar sepse ky njoftim ndalohej nga ligji i tyre kombëtar, ata gjithsesi bëjnë një njoftim i cili përmban sa më shumë nga të dhënat që janë në listë në këtë Seksion.

Në parim, informacioni i njoftuar do të kufizohet në shkelje të cilat kanë rezultuar ose kanë çuar në burgosje ose gjoba që kalojnë ekuivalentin e 2.000 US \$

12. Informacioni që do të dërgohet, të përmbajë sa më shumë që të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

- a) Emri (ose emri i firmës) dhe adresa;
- b) Emrat dhe të dhëna identifikuese për drejtuesit e firmës ndaj të cilëve është bërë një ndjekje penale;
- c) Lloji i mallrave;
- d) Vendi i origjinës;
- e) Kompania ndërkombëtare e lidhur;
- f) Emri dhe adresa e shitësit;
- g) Emri dhe adresa e transportuesit;
- h) Emrat dhe adresat e partnerëve të tjerë të implikuar (agjentë blerës apo shitës, ndërmjetës të tjerë, etj);
- i) Portet apo vendet e tjera ku mallrat u eksportuan;
- k) Të dhëna të shkurtra të shkeljes dhe kushtet që çuan në zbulimin e saj;
- l) Sasia e dënimit dhe deficiti i krijuar në të ardhurat që do mblidheshin, nëse ka;
- m) Vëzhgime të tjera që përfshijnë (nëse ka) ndonjë shkelje tjetër të regjistruar;
- n) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

PJESA II:

METODA TË KONTRABANDËS DHE MASHTRIME TË TJERA, DUKE PËRFSHIRË MASHTRIM ME FALSIFIKIM, DUPLIKIM FATURASH DHE FATURA TË GËNJESHTËRTA

13. Njoftimet nën këtë Pjesë do të japin informacion lidhur me metodat e kontrabandës dhe mashtrimet e tjera, duke përfshirë metodat e fshehjes, mashtrimin me falsifikim, duplikim faturash, fatura të gënjeshtërtë, në të gjitha rastet e interesave të rëndësishme ndërkombëtare. Palët Kontraktuese do të raportojnë çdo përdorim të metodave të reja të kontrabandës dhe mashtrimeve të tjera si metoda të reja dhe të pazakonta ose të mundshme në mënyrë që të zbulohen tendencat e reja në këtë fushë.

14. Informacioni që do të dërgohet të përmbajë sa më shumë që të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

- a) Përshkrimin e metodave të kontrabandës dhe mashtrimeve të tjera, duke përfshirë mashtrim me fshehje, falsifikim ose fatura të gënjeshtërtë. Nëse është e mundur, përshkrimin (modeli, pamja, numrat e regjistrimit) të mjeteve të transportit të përdorura. Kur është e mundur, të dhëna nga targat ose certifikatat e kontenerëve ose mauneve, format e të cilave janë aprovuar nga

një konventë ndërkombëtare, dhe informacione mbi dëmtimin e plumbosjeve, pjesëve të vulosura, pjesëve metalike dhe pjesëve të tjera të kontenierëve apo mjeteve.

b) Përshkrim, nëse është e mundur, të vendit të fshehjes, duke përfshirë nëse është e mundur një fotografi ose skicë.

c) Përshkrimi i mallrave të fshehura.

d) Natyra ose përshkrimi i falsifikimit, faturave të gënjeshtërtë, të duplikuara, mënyra e përdorimit të këtyre falsifikimeve, mashtrimeve, duplikimeve të gënjeshtërtë, vulave doganore, targave fallco etj.

e) Vëzhgime të tjera duke përfshirë rrethanat që çuan në zbulim

f) Pala Kontraktuese që dërgoi informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

PJESA III: MJETET LUNDRUESE TË PËRFSHIRA NË KONTRABANDË

15. Njoftimet nën këtë pjesë do të përmbajnë informacion lidhur me mjetet lundruese, të të gjitha tipeve, që janë implikuar në kontrabandë, por duhet të kufizohen, në parim, në rastet të cilat konsiderohen se janë të një interesi ndërkombëtar.

16. Për sa të jetë e mundur dhe aq sa e lejon ligji kombëtar, informacioni i dërguar duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) Emri dhe identifikime të shkurtra të mjetit (S.S, M.V, tonazhi, silueta, etj);

b) Emri dhe adresa e pronarit;

c) Flamuri;

d) Porti i regjistrimit, dhe nëse është i ndryshëm, porti vendas;

e) Emri dhe shtetësia/kombësia (dhe nëse është e mundur, oficerët kryesorë);

f) Natyra e shkeljes, duke përfshirë përshkrimin e mallrave të kapura;

g) Përshkrim, nëse është e mundur, të vendit të fshehjes, (duke përfshirë nëse është mundur fotografi ose skicë) dhe rrethanat e tjera që çuan në zbulim;

h) Vendi i origjinës së mallrave të kapura;

ij) Porti i parë hyrës;

k) Porti final i destinacionit;

l) Portet ku ndaloi midis (ij) dhe (k);

m) Vëzhgime të tjera (numri i rasteve në të cilat i njëjti mjet lundruar, kompani detare, karter ose operatorë të tjerë detarë kanë qenë të implikuara në kontrabandë etj.)

n) Pala Kontraktuese që dërgon informacionin (duke përfshirë numrin e referencës)

ANEKS X Asistencë në aksionet kundër kontrabandës së lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope

1. Dispozitat e këtij Aneksi nuk do të përjashtojnë aplikimin e masave në fuqi në nivel kombëtar për koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve të ndryshëm kompetente për të ndërmarrë aksione të tilla kundër abuzimit me lëndë narkotike dhe substancave të tjera psikotrope. Gjithashtu këto nuk do të pengojnë, por përmbushin, zbatimin e Dispozitave të Konventës së Vetme mbi Lëndët Narkotike 1961, dhe Konventës së 1971 mbi Substancat Psikotrope, nga Palët në këto Konventa të cilat kanë pranur gjithashtu këtë Aneks.

2. Dispozitat e këtij Aneksi që kanë të bëjnë me kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, do të aplikohen sa herë të jetë e përshtatshme dhe në mundësinë që japin kompetencat e Administratës Doganore, gjithashtu për operacionet financiare të ndërmarra në lidhje me këtë kontrabandë.

Shkëmbimi i informacionit nga Administratat Doganore sipas iniciativës së vet.

3. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, me iniciativën e vet dhe pa vonesë, do t'i komunikojnë Administratave të tjera Doganore të cilat mund të jenë vetë të interesuara, çdo informacion që ka, lidhur me:

a) veprime që dihen ose dyshohen që kanë kryer, ose duket se kanë bërë kontrabandë të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope;

b) personat që dihet se janë përfshirë, ose informacione lidhur me persona që i është komunikuar sipas ligjit, persona që janë përfshirë në pjesëmarrje në veprimet e referuara më sipër në paragrafin a) më sipër, dhe mjete transporti anije, avionë ose mjete të tjerë transportues të përdorur ose të dyshuar që janë përdorur për veprime të tilla;

c) mjete dhe metoda të tjera të përdorura për kontrabandën e lëndëve narkotike ose të substancave psikotrope;

d) produkte që janë zhvilluar ose përdorur për herë të parë si lëndë narkotike ose substanca psikotrope dhe të cilat janë subjekt kontrabande.

Asistencë, sipas kërkesës lidhur me survejimet.

4. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, në kuadrin e kompetencave dhe mundësive të saj, do të mirëmbajë survejim special për një periudhë të caktuar kohe mbi:

a) lëvizjet, veçanërisht hyrjet dhe daljet nga territori i vet i personave të veçantë që besohet me arsye se janë përfshirë profesionalisht ose në mënyrë të vazhdueshme në kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

b) lëvizjen e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, të cilat janë raportuar nga Administrata Doganore e Palës Kontraktuese Kërkuese se kanë shkaktuar rritje të trafikut ilegal të importit drejt ose nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) vende të veçanta ku janë ndërtuar grumbullime të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, të cilat japin shkaqe për të besuar se ato do të përdoren për import ilegal në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

d) mjete të veçanta, anije, avionë dhe mjete të tjera për të cilat besohet me arsye se janë përdorur për kontrabandë të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

dhe do t'i komunikojë një raport, lidhur me këtë, Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Kërkime, sipas kërkesës, për interes të një Pale tjetër Kontraktuese.

5. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vet, do të bëjë kërkime për të marrë fakte lidhur me kontrabandën e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope nën investigim në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese dhe të marrë deklarata nga çfarëdo personi të lidhur me këtë kontrabandë, ose nga dëshmitarë dhe ekspertë; dhe t'i komunikojë rezultatet e kërkimit, si dhe ndonjë dokument ose evidencë, Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Aksione nga oficerët e Doganës së një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

6. Kur nuk mjafton që evidencat të jepen vetëm në mënyrën e një deklarate me shkrim, sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, në kuadrin e mundësive të veta, do të autorizojë zyrtarët e saj të paraqiten përpara gjyqit ose tribunalëve në territorin e Palës Kërkuese Kontraktuese si dëshmitarë ose ekspertë në çështjet e kontrabandës së lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope. Kërkesa për paraqitje do të specifikojë, veçanërisht për çfarë çështje dhe në çfarë pozicioni do të dëgjohen këta zyrtarë. Administrata Doganore e Palës Kontraktuese që pranon kërkesën dhe autorizimin e paraqitjes, do të deklarojë limitet të cilat zyrtarët e saj do të përmbushin për të dhënë faktet.

7. Sipas kërkesës së shkruar të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kur shihet e përshtatshme dhe në kufijtë e kompetencave dhe mundësive të veta, do të autorizojë zyrtarët e Palës Kontraktuese për t'u prezantuar në territorin e Palës Kontraktuese që i kërkohet, lidhur me kërkimet ose për raportimet zyrtare lidhur me kontrabandën e lëndëve narkotike ose të substancave psikotrope që janë shqetësim për Palën Kontraktuese Kërkuese.

8. Kur shihet e mundur nga të dyja Palët Kontraktuese, dhe kushtëzuar nga ligjet dhe

rregullat në fuqi në territorin e vet, zyrtarët e Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së një Pale tjetër Kontraktuese, do të marrin pjesë në investigime të kryera në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

GRUMBULLIMI I INFORMACIONIT

9. Administrata Doganore e Palëve Kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, kur ky informacion është i një interesi të përbashkët, informacionet e specifikuar këtu.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të institucionalizojë dhe do të mbajë të rifreskuar një indeks qendror të informacionit, komunikuar atij nga Palët Kontraktuese dhe do të përdorë informacion prej tij për të përgatitur përmbledhje dhe studime mbi tendencat e reja dhe të vazhdueshme për kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope. Ai do ta rishikojë periodikisht këtë indeks për të eliminuar informacionet të cilat, sipas opinionit të tij, kanë kaluar dobishmërinë ose kanë dalë jashtë kohe.

11. Administrata Doganore e Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit dhe varur nga dispozitat e tjera të kësaj Konvente, do të furnizojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit me informacione të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të përgatitur përmbledhjet dhe studimet e referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

12. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do t'i shpërndajë shërbimeve ose zyrtarëve të caktuar nga Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese informacion specifik që përmbahet në indeksin qendror, aq sa e konsideron ai të dobishëm, si dhe përmbledhje dhe studime të përmendura në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

13. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, nëse nuk kundërshtohet nga Pala Kontraktuese që jep informacionin, gjithashtu, do t'u shpërndajë shërbimeve ose zyrtarëve të emëruar nga anëtarët e tjerë të Këshillit, trupave kompetente të Kombeve të Bashkuara, Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale/Interpol dhe organizatave të tjera me të cilat janë bërë marrëveshje lidhur me këto çështje, çfarëdoj informacioni lidhur me kontrabandën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope të përmbajtura në indeksin qendror, në limitet që ai i konsideron këto shpërndarje të dobishme, si dhe përmbledhje ose studime që ai mund të ketë përgatitur nën këtë temë sipas paragrafit 10 të këtij Aneksi.

14. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, sipas kërkesës, do të furnizojë Palët Kontraktuese që kanë pranuar këtë Aneks me çfarëdoj informacioni tjetër që ai ka në dispozicion lidhur me grumbullimin e informacionit të parashikuar në këtë Aneks.

INDEKSI QENDROR, PJESA I: PERSONAT

15. Njoftimet nën këtë Pjesë të Treguesit Qendror do të japin informacion lidhur me:

a) personat përfundimisht të dënuar për kontrabandë; dhe

b) kur është e mundur, persona të dyshuar për kontrabandë ose të përfshirë në akte kontrabande në territorin e Palës Kontraktuese që bën njoftimin, megjithëse procedimet penale mund të mos kenë përfunduar,

që kuptohet si: kur Palët Kontraktuese shmangen nga dhënia e njoftimit për emrat dhe përshkrimet e personave të implikuar në raste të tilla sepse njoftime të tilla janë të ndaluara nga legjislacioni i tyre kombëtar, ata gjithsesi duhet të bëjnë njoftime që të përmbajnë sa më shumë që të jetë e mundur nga të dhënat e përmendura në listën e kësaj Pjese të Indeksit Qendror.

16. Informacioni që do të dërgohet, të përmbajë sa më shumë që të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

a) Mbiemrin;

b) Emrin;

c) Emrin e dhënë (nëse ka);

d) Pseudonimet;

e) Profesionin;

- f) Adresa (e tanishme);
 - g) Datëlindja dhe vendlindja;
 - h) Shtetësia/Kombësia;
 - ij) Vendi i rezidencës dhe vendet e vizituara gjatë 12 muajve të fundit;
 - k) Tipi dhe numri i letrave të identifikimit, duke përfshirë datën dhe vendin e lëshimit;
 - l) Përshkrimi fizik;
 - 1. Seksi;
 - 2) Gjatësia;
 - 3) Pesha;
 - 4) Konstrukti;
 - 5) Flokët;
 - 6) Sytë;
 - 7) Kompleksi;
 - 8) Shenja dalluese ose femërore.
 - m) Përshkrime të shkurtra të shkeljes (duke përfshirë tipin, sasinë dhe origjinën e mallrave të përfshira në shkelje, prodhuesi, transportuesi dhe ndërmjetësi) si dhe konditat që çuan në zbulimin e shkeljes;
 - n) Natyra dhe sasia e shkeljeve ose dënimeve të dhëna;
 - o) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë gjuhën e folur dhe nëse është e mundur shkeljet e kaluara të regjistruara;
 - p) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).
17. Si rregull i përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të shpërndajë informacion lidhur me Pjesën I të Indeksit Qendror të paktën në vendet e Kombësisë/Shtetësisë, rezidencës dhe vendeve që ka vizituar ky person në 12 muajt e fundit.

INDEKSI QENDROR, PJESA II: METODAT

18. Njoftimet nën këtë Pjesë të Indeksit Qendror do të japin informacion lidhur me metodat e kontrabandës së lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, duke përfshirë metodat e fshehjes, në të gjitha rastet e interesave të rëndësishme ndërkombëtare. Palët Kontraktuese do të raportojnë çdo përdorim të metodave të njohura të kontrabandës, si dhe metoda të pazakonta ose të mundshme në mënyrë që të zbulohen tendencat e kohës në këtë fushë.

19. Informacioni që do të dërgohet të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

- a) Përshkrim të metodave të kontrabandës. Nëse ka mundësi, përshkrimi (ndërtimi, marka, modeli, numri i regjistrimit, etj), i çfarëdolloj mjeti transporti të përdorur. Kur është e mundur, të dhëna nga targa e aprovuar e certifikatës së Konteinierit apo mjetit, dizenjot e të cilave janë aprovuar nën një Konventë Ndërkombëtare, çfarëdolloj informacioni mbi dëmtimet e vulave, pjesëve metalike, pajisjeve vulosëse ose pjesëve të tjera të kontenierëve ose mjeteve.
- b) Përshkrim, nëse ka mundësi, të vendit të fshehjes, duke përfshirë nëse është e mundur një fotografi ose skicë.
- c) Përshkrim i mallrave në fjalë.
- d) Vëzhgime të tjera duke përfshirë rrethanat që çuan në zbulim.
- e) Palën Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

INDEKSI QENDROR, PJESA III: MJETET LUNDRUESE TË PËRFSHIRA NË KONTRABANDË

20. Njoftimet nën këtë Pjesë të Treguesit Qendror do të përmbajnë informacion lidhur me mjetet lundruese të të gjitha tipeve, të cilat janë përfshirë në kontrabandën e lëndëve narkotike ose substancave psikotrope, por duhet të kufizohet, në parim, në rastet të cilat konsiderohen se janë të një interesi ndërkombëtar.

21. Për aq sa lejon ligji kombëtar dhe sa të jetë e mundur, informacioni i dërguar do të

përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) Emri dhe identifikime të përmbledhura të mjetit lundruar (S.s., M.V., tonazhi, silueta etj.);
- b) Emri dhe adresa e pronarit, karter;
- c) Flamuri;
- d) Porti i regjistrimit, dhe nëse është i ndryshëm, porti vendas;
- e) Emri dhe shtetësia; kombësia e kapitenit (dhe nëse është e mundur, oficerët kryesorë);
- f) Natyra e shkeljes, duke përfshirë përshkrimin e mallrave të kapura;
- g) Përshkrimi nëse është e mundur i vendit të fshehjes (duke përfshirë nëse është e mundur një fotografi ose skicë) dhe përshkrim të rrethanave që çuan në zbulim;
- h) Vendi i origjinës së mallrave të kapura;
- i) Porti i parë i ankorimit;
- k) Porti final i destinacionit;
- l) Portet ku ka ndaluar ndërmjet i) dhe k);
- m) Vëzhgime të tjera (numri i rasteve në të cilat e njëjta anije, linjë detare, karter ose operator tjetër detar është përfshirë në kontrabandë, etj.);
- n) Pala Kontraktuese që jep informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

ANEKS XI

Asistencë në aksionet kundër kontrabandës së veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore

1. Dispozitat e këtij Aneksi aplikohen për veprat e artit, antikatat dhe “pasuritë e tjera kulturore”, të cilat në bazë besimi fetar, etj, janë të një rëndësie për arkeologjinë, parahistorinë, historinë, literaturën, artin dhe shkencën, sipas parimeve të paragrafit (a)-(k) të nenit 1 të Konventës UNESCO lidhur me kufizimin dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transportimin e vlerave kulturore (Paris, 14 nëntor 1970), për aq kohë sa vepra e artit, antikatat dhe pasuritë e tjera kulturore të jenë subjekt kontrabande. Ato nuk përjashtojnë aplikimin e masave kombëtare mbi kooperimin me shërbimet kombëtare për mbrojtjen e pasurive kulturore, dhe në fushën e doganave, përmbushin zbatimin e dispozitave të Konventës së UNESCO-s, nga Palët Kontraktuese për këtë Konventë të cilat gjithashtu kanë pranuar këtë Aneks.

2. Dispozitat e këtij Aneksi lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore, në kuadrin e kompetencave të Administratës Doganore dhe sa herë të jetë e mundur, do të zbatohen gjithashtu për operimet financiare të ndërmarra lidhur me këtë kontrabandë.

Shkëmbimi i informacionit nga Administratat Doganore me iniciativën e vet.

3. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, me iniciativën e vet dhe pa vonesë, do t'i komunikojnë Administratave të tjera Doganore që mund të jenë direkt të interesuara, çdo informacion që kanë në dispozicion lidhur me:

a) operacionet që dihen ose dyshohen, që përbëjnë, ose duket se kanë sjellë, kontrabandë të veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore;

b) personat që dihet se janë përfshirë, ose për aq sa, informacionet që kanë të bëjnë me këta persona mund të komunikohen në përputhje me ligjin kombëtar, personat e dyshuar që janë përfshirë në veprimet e referuara në paragrafin a) më lart, si dhe mjete lundrimi, anije, avionë dhe mjete të tjera transporti të përdorura ose që janë dyshuar se janë përdorur për këto operacione;

c) mjete ose metoda të reja të përdorura për kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore.

Asistencë, sipas kërkesës, lidhur me survejimet;

4. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të Palës Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, në kufirin e mundësive dhe kompetencave të veta, do të kryejë survejim special për një periudhë të caktuar kohe mbi:

a) lëvizjet, veçanërisht gjatë hyrjes ose daljes nga territori i vet i personave të veçantë që besohet se janë përfshirë, profesionalisht ose vazhdimisht, në kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese;

b) lëvizjet e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të cilat janë raportuar nga Administrata Doganore e një Pale Kontraktuese Kërkuese se kanë shkaktuar rritje serioze të trafikut ilegal nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) mjetet lundruese të veçanta, anije, aeroplanë ose mjete të tjera transporti për të cilat besohet me arsye se janë përdorur për kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore nga territori i Palës Kontraktuese Kërkuese;

dhe do të komunikojnë një raport lidhur me të Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Kërkime, sipas kërkesës, për interes të një Pale tjetër Kontraktuese.

5. Sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kushtëzuar nga mundësitë dhe varur nga ligjet kombëtare në fuqi në territorin e vet, do të bëjë kërkime për të marrë fakte lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore nën hetim në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese, dhe do të marrë deklarata nga çdo person i lidhur me këtë kontrabandë ose nga dëshmitarë dhe ekspertë, dhe do t'i komunikojë rezultatet e kërkimit, si dhe ndonjë dokument tjetër dhe evidence, Administratës Doganore të Palës Kontraktuese Kërkuese.

Aksione nga zyrtarët e Doganës së një Pale Kontraktuese në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese.

6. Kur njafton që faktet të jepen vetëm në formën e një deklarate të shkruar, sipas kërkesës së Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, për aq sa ka mundësi, do të autorizojë zyrtarët e saj të paraqiten përpara gjykatës ose tribunaleve në territorin e Palës Kontraktuese Kërkuese si ekspertë ose dëshmitarë në çështjet e kontrabandës së veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore. Kërkesa për paraqitje, do të specifikojë, për çfarë çështje dhe në çfarë pozicioni do të dëgjohen këta zyrtarë. Administrata Doganore e Palës Kontraktuese që pranon kërkesën, në autorizimin e paraqitjes, do të deklarojë limitet të cilat zyrtarët e vet duhet të përmbushin në dhënien e fakteve.

7. Sipas kërkesës me shkrim të Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e një Pale tjetër Kontraktuese, kur e sheh të mundur dhe në kufijtë e kompetencave dhe aftësive të veta, do të autorizojë zyrtarët e administratës kërkuese të jenë prezent në territorin e Palës Kontraktuese të cilës i kërkohet informacion lidhur me kërkimet mbi, ose do të autorizojë zyrtarët që do të raportojnë mbi kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore që shqetësojnë Palën Kontraktuese Kërkuese.

8. Kur shihet e përshtatshme nga të dyja Palët Kontraktuese dhe, kushtëzuar nga ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e tyre, zyrtarët e Administratës Doganore të një Pale Kontraktuese, sipas kërkesës së një Pale tjetër Kontraktuese, do të marrë pjesë në investigimet e kryera në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

GRUMBULLIMI I INFORMACIONIT

9. Administrata Doganore e Palëve Kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm, të Këshillit, në kushtet kur ky informacion është i një interesi ndërkombëtar, informacionin e specifikuar më poshtë.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të institucionalizojë dhe mbajë të freskët Indeksin Qendror të Informacioneve komunikuar atij nga Palët Kontraktuese dhe do të përdorë informacion prej tij për të përgatitur studime dhe përmbledhje të tendencave dhe mënyrave të reja në kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore. Ai, periodikisht, do të rishikojë indeksin për të eliminuar informacionet, që sipas mendimit të tij, kanë dalë jashtë kohe ose janë bërë të padobishme.

11. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, dhe kushtëzuar nga dispozitat e tjera të Konventës dhe këtij Aneksi, do të furnizojnë Sekretarin e Përgjithshëm me informacion të tillë shtesë që mund të jetë i nevojshëm për të përgatitur këto studime dhe përmbledhje, të referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

12. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do t'i shpërndajë zyrtarëve dhe shërbimeve të

emëruara nga Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese informacion specifik të përmbajtur në Indeksin Qendror, në kufijtë që ai i gjykon këto informacione të dobishme, si dhe përmbledhjet dhe studimet e referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

13. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, (nëse nuk kundërshtohet kjo gjë nga Palët Kontraktuese që kanë dhënë informacionin) do t'i shpërndajë këtë informacion UNESCO-s, Interpolit, lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të përmbajtura në indeksin qendror, kur ka ndodhur një transport ilegal dhe kur ai e konsideron këtë informacion të dobishëm, së bashku me ndonjë studim ose përmbledhje të cilat ai ka përgatitur për këtë çështje sipas paragrafit 10 të këtij Aneksi.

14. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, (nëse nuk kundërshtohet kjo gjë nga Palët Kontraktuese që kanë dhënë informacionin) do t'ua shpërndajë këtë informacion UNESCO-s, Interpolit, lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të përmbajtura në Indeksin Qendror, kur ka ndodhur një transport ilegal dhe kur ai e konsideron këtë informacion të dobishëm, së bashku me ndonjë studim ose përmbledhje të cilat ai ka përgatitur për këtë çështje sipas paragrafit 10 të këtij aneksi.

INDEKSI QENDROR, PJESA I: PERSONAT

15. Njoftimet nën këtë pjesë të Indeksit Qendror do të japin informacion lidhur me:

- a) personat përfundimisht të dënuar për kontrabandë; dhe
- b) kur është e mundur, personat e dyshuar për kontrabandë ose kapur në akte kontrabande në territorin e Palës Kontraktuese që bën njoftimin, megjithëse proceset penale mund të mos kenë përfunduar,

që duhet kuptuar se kur Palët Kontraktuese shmangen nga njoftimi i emrave dhe përshkrimeve të personave të përfshirë sepse këto njoftime ndalohen nga legjislacioni i tyre kombëtar, ata gjithsesi duhet të bëjnë njoftime që të përmbajnë sa më shumë nga të dhënat e vëna në listë më poshtë në këtë pjesë të indeksit qendror.

16. Informacioni që do të dërgohet, të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

- a) Mbiemri;
- b) Emri;
- c) Emri i dhënë;
- d) Pseudonimi;
- e) Profesion
- f) Adresa (e tanishme);
- g) Datëlindja dhe vendlindja;
- h) Shtetësia/Kombësia;
- i) Vendi i rezidencës dhe vendet e vizituara gjatë 12 muajve të fundit;
- k) Tipi dhe numri i letrave të identifikimit, duke përfshirë vendin dhe datën e lëshimit
- l) Përshkrimi fizik
 - 1) Seksi;
 - 2) Gjatësia;
 - 3) Pësia;
 - 4) Konstrukti;
 - 5) Flokët;
 - 6) Sytë;
 - 7) Kompleksi;
 - 8) Shenja të veçanta ose femërore.
- m) Përshkrim shkurt të shkeljes, (duke përfshirë përshkrim të tipit dhe origjinës së mallrave të përfshira në shkelje, dhe nëse është kryer një transport ilegal ose pronësi ilegale) dhe kushtet që çuan në zbulimin e shkeljes.
- n) Natyra dhe sasia e dënimit/gjobës së vënë;

o) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë gjuhën e folur, dhe (nëse ka mundësi) shkelje të kaluara të regjistruara

p) Palën Kontraktuese që ka dhënë informacionin (duke përfshirë numrin e referencës)

17. Si rregull i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do të qarkullojë informacionin lidhur me Pjesën I të Indeksit Qendror, të paktën në vendet e shtetësisë/kombësisë dhe rezidencës, si dhe në vendet që personi në fjalë ka vizituar 12 muajt e fundit.

INDEKSI QENDROR, PJESA II: METODAT

18. Njoftimet nën këtë Pjesë të Indeksit Qendror, do të japin informacion lidhur me metodat e kontrabandës së veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore, duke përfshirë metodat e fshehjes, në gjithë rastet e interesave të rëndësishëm ndërkombëtare. Palët Kontraktuese do të raportojnë çdo lloj përdorimi të metodave të njohura të kontrabandës, si dhe të metodave të pazakonta, ose të mundshme në mënyrë që tendencat e reja në këtë fushë të mund të zbulohen.

19. Informacioni që do të shpërndahet, sa më shumë të jetë e mundur të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) Përshkrim të metodave të kontrabandës. Nëse është e mundur, përshkrimin (marka, modeli, numri i regjistrimit, në rastet e mjeteve tokësore, tipi i mjetit lundrues, etj.) të çdo mjeti transporti të përdorur. Kur është e mundur, të dhëna nga targat e aprovuara ose certifikatat e kontenierëve ose mjeteve lëvizës, disenjot e të cilave janë aprovuar nën një Konventë Ndërkombëtare, si dhe për ndonjë dëmtim të vulave, pjesëve metalike, plumbosjeve, ose pjesëve të tjera të mauneve ose kontenierëve.

b) Përshkrim, nëse ka mundësi të vendit të fshehjes, duke përfshirë nëse ka mundësi, një fotografi ose skicë;

c) Përshkrim i mallrave në fjalë;

d) Vëzhgime të tjera, duke përfshirë rrethanat që çuan në zbulim;

e) Palën Kontraktuese që dërgon informacionin (duke përfshirë numrin e referencës).

L I G J

Nr.8760, datë 26.3.2001

PËR PAGESAT ME KËSTE TË TAKSAVE NGA OPERATORËT PRIVATË RADIO DHE TELEVIZIVË GJATË PERIUdhËS TRANZITORE TË VITIT 2001

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I :

Neni 1

Pavarësisht nga nenet 33 pika 5 dhe 137 pika 2 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, veprimtaria e subjekteve radiotelevizive të licencuara nuk konsiderohet se është në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, në qoftë se këto subjekte paguajnë taksat dhe tarifat e tjera në përputhje me këtë ligj.

Përrjashtimisht për vitin 2000 dhe 2001, detyrimet e operatorëve privatë radio dhe televizivë, që rrjedhin nga ligji nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” do të paguhet me këste tremujore brenda datës 31.12.2001.

Për mospagimin në afat të kësteve zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2961, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

V E N D I M **Nr.478, datë 9.3.2001**

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR VERIFIKIMIN E LISTAVE DHE TË NDARJES SË ZONAVE ZGJEDHORE

Në mbështetje të neneve 30 dhe 88 të Rregullores të Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË **V E N D O S I :**

Neni 1

Krijimi dhe kompetencat e Komisionit

1. Krijohet Komisioni i Posaçëm Parlamentar me qëllim verifikimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

2. Komisioni duhet të paraqesë në Kuvend raportin përfundimtar në lidhje me procesin përgatitor për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2001 dhe në veçanti për:

verifikimin e saktësisë së listave zgjedhore;

b) zbatimin e kërkesave të nenit 71 të Kodit Zgjedhor për ndarjen e zonave zgjedhore.

Neni 2

Përbërja e Komisionit

Komisioni përbëhet nga 6 anëtarë, 3 të propozuar nga pozita parlamentare dhe 3 nga opozita parlamentare.

Neni 3

Afati i veprimtarisë së Komisionit

1. Komisioni e fillon veprimtarinë e tij në datën e vendimit të Kuvendit për caktimin e anëtarëve të tij.

2. Veprimtaria e Komisionit përfundon me paraqitjen e raportit të tij para Kuvendit në seancë plenare, i cili duhet të paraqitet të paktën 50 ditë përpara datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin.

Neni 4

Fuqitë e Komisionit

Komisioni ka karakter verifikues të zbatimit të kuadrit ligjor zgjedhor, dhe mund të paraqesë në Kuvend amendamente, të cilat ai i konsideron të nevojshme, për ligje.

Neni 5

Kontrolli dhe verifikimi i dokumenteve

1. Komisioni ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi listat e zgjedhësve, mbështetur në dispozitat e Kodit Zgjedhor.
2. Komisioni përcakton njësitë zgjedhore, ku do të ushtrojë kontroll për listat e zgjedhësve.
3. Komisioni kontrollon nëse zonat zgjedhore janë ndarë në përputhje me nenin 71 të Kodit Zgjedhor.
4. Për realizimin e detyrave të parashikuara në këtë vendim, organet shtetërore, të ngarkuara me detyra në procesin zgjedhor, janë të detyruara të paraqesin dokumente dhe të krijojnë lehtësitë e nevojshme.

Neni 6

Votimi

1. Komisioni, si rregull, merr vendime me konsensus. Në rast se konsensusi nuk realizohet, vendimet merren me shumicën relative të votave.
2. Radha e votimit në Komision bëhet sipas rendit alfabetik të emrit të anëtarëve të tij. Kryetari voton i fundit.

Neni 7

Këshilltarët teknikë

1. Komisioni me konsensus emëron katër këshilltarë teknikë.
2. Kriteret e përzgjedhjes së këshilltarëve dhe funksionet e tyre përcaktohen me vendim të veçantë të Komisionit.

Neni 8

Raportimet në Kuvend

Komisioni raporton në seancë plenare me kërkesën me shkrim të jo më pak se 10 deputetëve.

Neni 9

Raporti përfundimtar

Raporti përfundimtar i Komisionit duhet të miratohet nga Kuvendi me konsensus dhe, kur ai nuk realizohet, miratohet me shumicën relative të votave.

Neni 10

Zbatimi i vendimit të Kuvendit

Për zbatimin e vendimit të tij, Kuvendi ushtron të gjitha kompetencat e përcaktuara në dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Neni 11

Fondi financiar i Komisionit

1. Nga buxheti i Kuvendit për vitin 2001, Komisionit i caktohet një fond i veçantë me vendim të Kryetarit të Kuvendit, mbështetur në propozimin e Komisionit.
2. Mënyra e administrimit të këtyre fondeve përcaktohet me vendim të veçantë të Komisionit.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.479, datë 9.3.2001

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR
VERIFIKIMIN E LISTAVE DHE TË NDARJES SË ZONAVE ZGJEDHORE**

Në mbështetje të neneve 30 dhe 88 të Rregullores të Kuvendit dhe të nenit 2 të vendimit të Kuvendit nr.478, datë 9.3.2001 “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për verifikimin e listave dhe të ndarjes së zonave zgjedhore”, me propozimin e pozitës dhe të opozitës parlamentare,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Caktohen anëtarë të Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për verifikimin e listave dhe të ndarjes së zonave zgjedhore deputetët e mëposhtëm:

1. Ylli Bufi- Kryetar
2. Spartak Braho- anëtar
3. Pavli Zëri- anëtar
4. Vili Minarolli- anëtar
5. Spartak Ngjela- anëtar
6. Ylli Vejsiu- anëtar

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.482, datë 26.3.2001

**PËR MOSMIRATIMIN E MOCIONIT PËR DEBAT ME OBJEKT PROPOZIMIN PËR
SHKARKIMIN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Kushtetuese e Ligjore dhe të Komisionit të Mandateve, Imunitetit e të Rregullores ,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Nuk miratohet mocioni për debat me objekt propozimin për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KUVENDI I SHQIPËRISË

DEKLARATË

datë 9.III.2001

Kuvendi i Shqipërisë vëren me shqetësim se qendrave të tensionit si Mitrovica e Lugina e Preshevës iu shtua së fundi edhe konflikti në fshatin Tanushevc të Maqedonisë. Kuvendi i Shqipërisë konfirmon edhe njëherë se është me vendosmëri kundër dhunës dhe ekstremizmave të çdo lloji. Çështjet që përbëjnë shqetësim mund të duhet të zgjidhen kurdoherë vetëm nëpërmjet bisedimeve.

Kuvendi ynë distancohet nga veprimet e dhunës të ndonjë grupi të shfaqur në Maqedoni nën etiketime kombëtare. Ne kemi përkrahur e përkrahim mbarëvajtjen dhe stabilitetin në Maqedoni si një nga pikat kyçe të stabilitetit në rajon.

Ne ftojmë autoritetet maqedonase të tregojnë vetëpërmbytje lidhur me ngjarjet e fundit. Në tërësinë e këtyre ngjarjeve, të identifikohet përkatësia e personave që kryejnë akte terroriste, pa kaluar nga një incident i izoluar në një krizë të përgjithshme, sidomos të mos ndodhin shpërngulje të popullsisë. Problemet e brendshme të Maqedonisë nuk janë probleme të Kosovës. Bllokimi i kufirit me të, qoftë edhe i përkohshëm dhe kërkesa për një zonë tamponi në këtë kufi, janë të paarsyeshme. Shqiptarët që banojnë në të dy anët e kufirit kanë lidhje të përhershme dhe qarkullimi ndërmjet tyre s'mund të pengohet. Kurse marrëveshja e nënshkruar në Shkup nga Presidenti i Maqedonisë dhe z. Koshtunica mbi vijën e kufirit të dy vendeve është e pazbatueshme.

Ne shfaqim bindjen se zgjerimi i bashkëqeverisjes, i problemit të dy gjuhësisë e të tjera, që bëhen burim tensionesh, do të çohen përpara me durim e dialog paqësor, duke forcuar gjithnjë më tej stabilitetin e shtetit maqedonas.

Kuvendi vëren me shqetësim prirjen e kryetarëve të disa shteteve për të zmadhuar jashtë mase incidentet e fundit në Maqedoni, duke i ofruar asaj deri edhe ndihma ushtarake. Sovraniteti i ish-R.J. të Maqedonisë nuk është nën kërcënim dhe akuza që iu bëhet në këtë drejtim shqiptarëve është krejt e pabazuar. Ndërrhyrjet e njëanshme të këtyre shteteve në çështjet e Maqedonisë e të Kosovës janë negative e duhet të marrin fund.

Kuvendi pohon se UNMIK-u dhe KFOR-i kanë qenë dhe janë faktor i pazëvendësueshëm i ruajtjes së paqes në rajon. Nën kujdesin e këtyre strukturave Kosova po shkon paqësisht drejt zgjedhjeve të përgjithshme dhe referendimit që do të përcaktojë të ardhmen e saj.

Ngjarjet në Kosovë e rreth saj dhe në ish-R.J. të Maqedonisë shpjegohen kryesisht me angazhimin e forcave të caktuara në Serbi e gjetkë, për të penguar proceset demokratike në Kosovë dhe për të hedhur sërish rajonin në luftë. Kjo duhet të tërheqë vëmendjen e strukturave ndërkombëtare. Perspektivat që trupat serbe të hyjnë në zonën asnjansë në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk e pakëson, por rrit rrezikun e konflikteve. Strukturave ushtarake serbe, të akuzuara për gjenocid dhe ende të indoktrinuara, s'mund t'u besohet roli i paqeruajtësve.

Duke parë rrezikun serioz të zhvillimeve të tilla, Kuvendi u bën thirrje shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni të tregojnë maksimumin e vëmendjes dhe të mënjanojnë energjikisht çdo shfaqje të dhunës dhe ekstremizmit, si dhe përshëndet me këtë rast deklaratimet, në këtë kuadër, të forcave politike shqiptare në Kosovë e Maqedoni.

V E N D I M
Nr.127, datë 15.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.415, DATË 1.7.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT "GRUAJA DHE FAMILJA""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.415, datë 1.7.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titull dhe në pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi emërtimi "Gruaja dhe familja" zëvendësohet me emërtimin "Për mundësi të barabarta".

2. Në pikën 2 në shkronjat "a" dhe "c", fjalët "gruan dhe familjen", shkronjën "d", fjalët "të drejtat e gruas dhe çështjet e familjes" zëvendësohen me fjalët "mundësi të barabarta". Ndërsa në shkronjat "b", "e" dhe "f", fjalët "gruas dhe familjes" zëvendësohen me fjalët "mundësive të barabarta".

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1 dhe 3.2. me këtë përmbajtje:

"3.1. Paga e kryetarit të Komitetit "Për mundësi të barabarta" të jetë sipas klasës B/1, në lidhjen 1 "Renditja e funksioneve sipas klaisifikimit", mbështetur në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndërsa paga e punonjësve të këtij Komiteti të jetë sipas lidhjes II/5, "Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore."

"3.2. Për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, për mundësi të barabarta gjinore, krijohet Këshilli Qendror, me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale kryetar
- Ministri i Drejtësisë anëtar
- Ministri i Arsimit dhe Shkencës anëtar
- Ministri i Shëndetësisë anëtar
- Zëvendësministri i Financave anëtar
- Zëvendësministri i Rendit Publik anëtar
- Kryetari i komitetit "Për mundësi të barabarta" anëtar
- dy përfaqësues të grupimeve më të mëdha të OJQ-ve, nga rradhët e grave anëtar

Për punën e kryer anëtarët e këtij këshilli shpërblehen sipas vendimit nr.720, datë 29.11.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë, që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore."

4. Pikat 4 dhe 5 të vendimit shfuqizohen.

5. Pika 6 ndryshon si vijon:

"Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Financave, Këshilli dhe Komiteti "Për mundësi të barabarta" për zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.128, datë 15.3.2001

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 220/110 KV, NË SHARRË, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 5/1, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik, të truallit prej 8000 m², të pronarëve a bashkëpronarëve që preken nga ndërtimi i nënstacionit 220/110 KV, në Sharrë, Tiranë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, me vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 39 009 600 (tridhjetë e nëntë milionë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekësh.
 4. Punimet përfundimtare të ndërtimit në nënstacionin 220/110 KV, në Sharrë, Tiranë, janë mbyllur.
 5. Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, sh.a., Tiranë, brenda fondit të programuar për ndërtimin e këtij nënstacioni, të bëjë likuidimin e pronarëve.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
220/110 KV NË ZONËN E VARREZAVE SHARRË**

Nr.	Emri Mbiemri	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë)	Vlerësimi
1.	Ibrahim Muça përfaqësuar me prokurë nga Enver Muça	2000	35x39.32=4876.2	9752400
2.	Selman Muça përfaqësuar me prokurë nga Enver Muça	4000	35x139.32=4876.2	19504800
3.	Myslym Muça përfaqësuar me prokurë nga Enver Muça	2000	35x139.32=4876.2	9752400
		Sp=8000	4876.2	39009600

Fletorja Zyrtare gjendet:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 13.4.2001
Doli nga shtypi më 16.4.2001

Tirazhi: 4200 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”, Tiranë

Çmimi: 200 lekë